



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
Nr.01-060/01-4731/24 datë: 16.02.2024



Npi – 01/62 datë:16.02.2024

Bazuar në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr.28, datë 04.06.2008); Nenit 32, dhe 37 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës Nr.02/2015 të datës 28.12.2015; Si dhe në bazë të nenit 4 dhe 6 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi-01/155 të datës 27.04.2023, Kryesuesi i Kuvendit vendosi të bëjë këtë:


**F T E S Ë**

**PËR MBLEDHJEN E -II- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES**

E cila do të mbahet në sallën e Kuvendit më: 26.02.2024 (e hënë) Në ora: 09:00h

**R E N D I T E**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 31.01.2024,
2. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024, (pas diskutimit Publik)
3. Informatë për zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për 2022,
4. Prop-Vendim për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024,
5. Prop-Vendim për formimin e Komisioneve për ndarjen e qmimeve “Nderi i Qytetit” dhe “Qytetar Nderi”.
6. Prop-vendim për caktimin e çelësit për zgjedhjen e komisioneve për ndarjen e qmimeve “Sakrifica Reçakut-1999” dhe “Pena e Artë”.
7. Draft-Rregullore Komunale për Transparencë, (pas diskutim publik),
8. Draft-Plani i veprimit për transparencë komunale 2024-2028, (pas diskutim publik),
9. Draft-Plani i Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026,
10. Pyetje – Përgjigje,
11. Informatë nga DKA për përfundimin e gjysëm-vjetorit të parë shkollor 2023/24,
12. Informatë nga DPUKGJ lidhur me legalizimin e objekteve pa leje ndërtimi,



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KUVENDI KOMUNAL / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY**  
**SHTIME / ŠTIMLJE**



Data/Datum/Date:	16.02.2024
Nr./Br./No:	02/92
Për/Za/To:	Kuvendi i Komunës-Shtime, Kryesuesi z. Adnan Ademi
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	Zyra e Kryetarit të Komunës së Shtimës, z. Qemajl Aliu
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim-Vendim për formimin e komisioneve për ndarjen e çmimeve "Nderi i Qytetit" dhe "Qytetar Nderi"

Të nderuar anëtarë të Kuvendit e Komunës së Shtimes;

Në mbështetje të vendimit 01/41 të datës 31.01.2024 të Kuvendit të Komunës së Shtimes për miratimin e çelësit për zgjedhjen e Komisioneve për ndarjen e çmimeve "Nderi i Qytetit" dhe "Qytetar Nderi", si dhe në bazë të nenit 10 të Rregullores Komunale Npi - 01/173 të datës 27.05.2009 për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet, si dhe të nxitur nga nevoja e ndarjes së dekoratave për personalitetet e ndryshme që kanë dhënë kontribut domethënës, ashtu që konform procedurave të kemi mundësinë për t'i nderuar nga Komuna e Shtimes, në mbështetje të procedurës së kërkuar sipas dispozitave të aktit nënligjor, ju ftoj të miratoni këtë Propozim-vendim për formimin e komisioneve për ndarjen e çmimeve "Nderi i Qytetit" dhe "Qytetar Nderi":

**Formimi i Komisionit për ndarjen e çmimeve "Nderi i Qytetit":**

1. \_\_\_\_\_ Anëtar nga Kuvendi,
2. \_\_\_\_\_ Anëtar nga Kuvendi,
3. \_\_\_\_\_ I emëruar nga Kryetari i Komunës,
4. \_\_\_\_\_ I emëruar nga Kryetari i Komunës,
5. \_\_\_\_\_ Nga Shoqëria Civile.

**Formimi i Komisionit për ndarjen e çmimeve "Qytetar Nderi":**

1. \_\_\_\_\_ Anëtar nga Kuvendi,
2. \_\_\_\_\_ Anëtar nga Kuvendi,
3. \_\_\_\_\_ I emëruar nga Kryetari i Komunës,
4. \_\_\_\_\_ I emëruar nga Kryetari i Komunës,
5. \_\_\_\_\_ Nga Shoqëria Civile.

Ju ftojme të miratoni këtë Propozim-vendim që e mundësoni ndarjen e këtyre çmimeve.

Ju faleminderit!

Adresa: Rr. Tiranës, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.  
 Tel.: +381290389016, email: info@shtime-komuna.org  
<http://kk.rks-gov.net/shtime>



REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Buxhet dhe Financa  
Direktorat za Budžet i Finansije

Data/Datum/Date:	20.02.2024
Nr./Br./No	11/31
Për/Za/To:	Kuvendin Komunal Komitetin për Politikë dhe Financa
Përmes/Preko/Through:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Besnik Ahmeti-Drejtor i Drejtorise për Buxhet dhe Financa Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesor Financiare
Lënda/Predmet/Subject :	RAPORTI PERIODIK PER ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TE ZKA PER VITIN 2022

Ile nderuar,

Bazuar në Rregulloren e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit i nxjerrur nga Ligji 05/L-055, neni 14- Plani i veprimit dhe njoftimi periodik lidhur me rrjedhën e zbatimit të tij ku thuhet se pas hartimit të planit të veprimit entiteti i audituar i dorëzon Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve.

Ju lutem, gjeni të bashkangjitur dokumentin:

Raporti Periodik për zbatimin e Rekomandimeve

Me respekt!



Për: Komitetin për Politikë dhe Financa -Kuvendin e Komunës

Nga z.Qemajl Aliu, Kryetar I Komunës

Datë: 20.02.2024,

Shtime

**RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E  
REKOMANDIMEVE 2022**  
Të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra  
Kombëtare e Auditimit

Nr	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Zyrtari/ët përgjegjës	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin të rekomandimit	Statusi i rekomandimit (zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pazbatuar)	Sfidet e hasura në zbatimin e rekomandimit
----	------------------------------------	--------	-------------	-----------------------	--	--	--

1	<p>Mos publikimi i projektit ekzekutiv në tenderët për punë</p>	<p>Neni 28.10 i LPP kërkon: Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përfaqësojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përshihin, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet të bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohej që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se për çdo procedurë tenderuese se projektit ekzekutiv të bëjë publikimin e tij se bashku me dokumentacionin tjetër për atë tender.</p>	<p>Kryetari Drejtori i prokurimit Menaxheri i zyrës së prokurimit</p>	<p>Drejtorja e Prokurimit Mbajtja e një rexhistri të tërheqjes së Specifikacionit të projekteve në raste kur nuk mundë të ngarkohen në E-prokurim për arsye Teknik.</p>	<p>TM3 – TM4 2023  I Zbatuar</p>
---	---	--	---	---	---	--

Kjo sipas zyrtareve të komunës, kishite ndodhe për shkak të mos përkrahjes teknike e platformes e-prokurimi shkaku i hapësirës së panjafsheshme për të ngarkuar në sistem të gjitha ato materiale elektronike voluminoze.

<p>2</p>	<p>Mungesa e planit vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve</p>	<p>Rregullorja 04/2017-nbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 6, ofruetit e mbështetjes financiare përgatitshin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të në së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës.</p> <p>Komuna edhe pse me Buxhet të Kosovës kishte paraparë që gjatë vitit 2022 të ofrojë mbështetje financiare për projektet dhe programet e OJQ-ve, megjithatë nuk kishte përmbushur kërkesën ligjore për përgatitjen e Planit Vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve.</p> <p>Mos marrja e masave të nevojshme për rritjen e llogaridhënies për menaxhimin e mirëfilltë të subvencioneve, ishte shkak për mos përgatitjen e planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që komuna të përgatitë planin vjetor për mbështetje financiare për OJQ-ve dhe të njëjtat t'i dërgohen me kohë zyrës për qeverisje të mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe të siguroj se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregulloren për mbështetje financiare.</p>	<p>Kryetari përmes Drejorisë përkatëse në harmoni me rregulloren 04/2017 do të hartojnë planin vjetor për mbështetje financiare për OJQ</p>	<p>Plani vjetor është hartuar dhe dorzuar për vitin 2023</p>	<p>TM1 2023</p> <p>I zbatuar</p>
----------	--	--	--	---	--	----------------------------------



<p>3</p> <p>Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kategorinë ekonomike</p>	<p>Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18, pika 3 përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.</p> <p>Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve në vlerë prej 9,870€ pasi që shërbimet e varrimit ishin paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa ishte dashur që pagesa të bëhet nga kategoria e subvencioneve.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe mangësisve në menaxhtimin e obligimeve.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me planin kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël.</p>	<p>Drejtorja përkatëse të konsultoj Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, gjatë procesit përkatëse ka ndërmarrë masa dhe ka implementu këtë rekomandim</p>	<p>TMI 2023</p> <p>I Zbatuar</p>
--	--	---	---	----------------------------------

<p>4 Efiikasiteti i ulët në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme</p>	<p>Sipas Rregullores së Ministrisë së Financave nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Arkëtimi i të hyrave duhet të bëhet sipas afatëve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.</p> <p>Sipas regjistrave, vlera e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2022 ishte 755,644€ Rrija në krahasim me vitin 2021 ishte 51,989€ ose 7.4%.</p> <p>Sfida kryesore mbetet arkëtimi i tatimit në pronë (parcele), i cili është rritur për 53,325€ ose 30% në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021. Nga borxhet e tatimit në pronë, 57,584€ i përkasin ish Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH). - Nga testimi i mostrave tek shfrytëzimi i pronës publike, kemi identifikuar mungesë të dokumentacionit si: aktvendimet për ngarkesën (faturat), kartelat analitike të klientëve që dëshmojnë të drejtën për arkëtim. Vlera e përgjithshme e llogarive të arkëtueshme për këtë kategori është 1,987€ dhe nuk janë bërë përpjekje për arkëtimin e tyre.</p> <p>Kjo ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit të kontroleve të brendshme në marrjen masave për arkëtim, si dhe në ruajtjen e dokumentacionit për llogaritë e arkëtueshme të shfrytëzimit të pronës publike.</p>	<p>Zyra e Tatimit në Pronë.</p> <p>Zyra e tatimit në pronë është duke u angazhuar për eliminimin e kësaj të Ejeture. Angazhimi: Ftesa për takime Njofitimi I obliguesve tatimor për shumat e obligimeve Bazën ligjore për inkasimin e detyruar.</p>	<p>TM3- TM4 2023 Në Proces</p>
---	---	---	--------------------------------

<p>5. Illogaritë e arkëtueshmë nga tatimi në pronë për Ndërmarrje Shoqërore</p>	<p>Ligji Nr. 06/L-005 për tatimin në pronë, nenin 12 paragrafi 2, përcakton se çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e patajishme që ndodhen brenda territorit të komunës. Nga tatimi në pronë prej 753,657€, ku një pjesë e borxheve të tatimit në pronë prej 57,584€ i përkasin ish Ndërmarrjeve Shoqërore (NSb). Këto llogari të arkëtueshme janë bërë barrë aktuale vjetore e faturs së tatimit në pronë të cilat po rriten vit pas viti, dhe gjasat për inkasim të detyrueshëm mund të jenë të vogla. Sipas kontratës me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) blerësi i ri i pronës shoqërore ka obligim të paguaj tatimin në pronë vetëm për 12 muaj kalendarak, kurse pjesa tjetër e borxhit paguhet gjatë procesit të likuidimit. Gjatë vitit 2022 komuna e Shtimes nuk kishte komunikuar me AKP-në si dhe deri në kohën e auditimit zgjidhja nuk është arritur. Kjo kishite ndodhur për shkak të mungesës së njohurive të zyrtarëve për mos lejimin e shpenzimeve të parashë publike për këtë qëllim.</p>	<p>Kryetari të ndërmerr veprime adekuatë për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet e NSh-ve të cilat janë nën menaxhimin e tyre dhe të ish NSh-ve të privatizuara</p>	<p>Zyra e Tatimit në Pronë.</p>	<p>Gjatë takimeve me grupin e veprimit është diskutuar kjo e gjetur dhe kemi ardhur në përfundim për adresimin e saj aranzhimin e një takimi apo pregaditja e dokumentacionit për AKP-në.</p>	<p>TM3-TM4 Në proces</p>
---	---	--	---------------------------------	---	------------------------------

6	<p>Mos kompletimi i NJAB-së</p>	<p>Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njësise së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi 7,000,000 duhet të ketë së paku tre auditorë</p> <p>Komuna ka të themeluar NJAB i cili përbëhet vetëm nga Drejtori i auditimit. Sipas rregullores komuna i plotëson kriteret që njësia të ketë në total tre (3) auditorë.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak nuk kishte shpallur konkurs për plotësimin e këtyre pozitave.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë buxhetimin dhe plotësimin me staf të mjaftueshëm të NJAB-së për të ndikuar në forcimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme në komunë.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë hartimit të buxhetit 2024-2026 të analizohet dhe të buxhetohet e gjetura.</p>	<p>Procesimi në buxhetin 2024-2026.</p>	<p>TM3 TM4 2023</p> <p>Në Proces</p>
---	---------------------------------	---	---	---	---	--

7	<p>Dobësi në menaxhimin e subvencioneve dhe transfereve</p>	<p>Sipas nimit 20 të Rregullores së brendshme të komunës për ndarjen e subvencioneve dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizik përfshijnë ndër të tjera: numrin identifikues të fermerit, projektin financiar, fletë posedimin për patundshmëri, dëshmi për pagesën e taksave komunale, dëshmi mbi pagesën e tatimit në pronë, konfirmimin nga banka për xhirologarinë e aplikuesit. Poashtu, sipas nimit 20 të rregullores së MF-së nr. 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nga aplikuesit e përzgjedhur në listën e rezultateve paraprake kërkohet të sjellin dëshminë se kanë kryer të gjitha obligimet.</p> <p>Ne kemi identifikuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Thirrja publike për subvencionimin e fermerëve në bujqësi për furnizim me serra në sipërfaqe prej 50m2 nuk ishte në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara me rregulloren e brendshme të komunës, sepse mungonin kërkesat e përcaktuara me rregulloren si në vijim: projekti financiarë dhe fletëposedimi për patundshmëri.</li> <li>• Për subvencionin me vlerë 3,000€ për klubin e hendbollit për femra ne kemi identifikuar se në dosje i mungonin dëshmitë se kanë kryer të gjitha obligimet latimore.</li> </ul> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirëfilltë të kontrolleve të brendshme gjatë përgatitjes së thirrjeve publike dhe vlerësimit të dosjeve të aplikuesëve për subvencione.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për forcimin e kontrollit të brendshme në mënyrë që dokumentet e nevojshme për subvencionimin e fermerëve të jenë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregulloren e brendshme të komunës për subvencione.</p>	<p>Zyra e kryetarit dhe të gjitha drejtorit.</p>	<p>Drejtoritë përkatëse të sigurohen se janë duke u zbatuar rregulloret në fuqi për ndarjen e subvencioneve</p>	<p>TM3 TM4 2023</p> <p>I Zbatuar</p>
---	---	--	---	--	---	--

<p>8</p> <p>Mangësi në regjistrat e pasurive</p>	<p>Rregullorja nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare, neni 2 - Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, ljetësimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi. Ndërsa neni 6 - regjistri i pasurive jo financiare, paragrafi 3. Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".</p> <p>Nga procedurat tona substanciale të auditimit kemi vërejtur se pasuritë në PVF ishin mbivlerësuar në vlerë prej 123,540€, kjo për arsye se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Regjistri i pasurisë nuk ishte i saktë pasi që 66 pasuri kapitale me vlerë neto prej 142,401€, ishin regjistruar si jokapitale (nën 1,000€), prej tyre 20 pasuri ishin regjistruar dyfish edhe si kapitale edhe si jokapitale. Kjo kishte ndikuar në mbivlerësimin e pasurive jokapitale në PVF për këtë vlerë.</li> <li>Regjistri i pasurisë kapitale (mbi 1000€) është nënvlerësuar në vlerë neto prej 43,253€ shumë kjo e cila përfshinë 47 pasuri të ndryshme si: Laptop, kompjuter, makina autolarëse, gjenerator etj dhe pagesën për mirëmbajtje investive "Rregullimi i hapësirave tek Shtëpia e Kulturës, Palestra e qytetit dhe Muzeu Shtime".</li> <li>Regjistri i pasurisë kapitale poashtu ishte mbivlerësuar me një vlerë prej 24,392€, pasi që në regjistrat ishin përfshirë tri (3) vetura me vlerë 9,689€ të cilat sipas normës së zhvlerësimit do duhej ta kishin vlerën neto në liria zero (0), si dhe gjashtë (6) vetura të</li> </ul>	<p>Kryetari duhet të siguroj se me rastin e gjenerimit të raporteve të e-pasurisë të shtohet kujdesi dhe të funksionoj kontrollin në regjistrimin përkatësist largimin me kohë të pasurive kapitale në mënyrë që pasuria e prezantuar në PVF të jetë e plotë dhe e saktë.</p>	<p>ZKF.Zyrtarja e pasurisë</p>	<p>Gjatë takimeve të Grupit të Veprimit është rikujtuar obligimi për implementimin e këtij Rekomandimi.</p>	<p>TM3 TM4 2023 I zbatuar</p>
--	---	---	--------------------------------	---	---------------------------------------

				Drejtoria e Prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë masat e nevojshme në mënyrë që procedurat e prokurimit të zhvillohen sipas kërkesave të rregullës përkatëse të prokurimit publik.	Sipas nenit 48.2 të rregullës së prokurimit publik nr.001/2022 për raste të emergjencës ekstreme- ekziston mundësia të përdoret procedura e negociuar pa publikuar njoftimin e kontratës. Kushtet dhe rrethanat për përdorimin e procedurave emergjente janë domosdoshmëria strikte e zhvillimit të një aktiviteti prokurimi në baza emergjente, motivuar nga ngjarje të verifikueshme në mënyrë objektive që nuk ishin të parashikueshme nga autriteti kontraktues, rrethanat emergjente nuk i atribuohen veprimeve negjizhente apo qëllimstme ose mosveprimeve të autoritetit kontraktues.	Procedurat e prokurimit për furnizim me pajisje të IT nuk ishte në pajtueshmëri me rregullat e prokurimit publik	9	TM3=TM4 2023  I Zbatuar	

cilat figuronin në regjistrë me vlerë 14,703€ të cilat komuna i kishte shitur dhe ende nuk ishin larguar nga regjistri i pasurive.  
Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i kujdesit jo të duhur dhe kontrolleve joefikase në azhurnimin dhe mirmbajtjen e regjistrave të pasurisë jo-financiare kapitale dhe jo kapitale.

10	Mbvlerësimi i detyrimeve kontingjente.	<p>Komuna kishte dërguar në KRPP njoftimin për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. KRPP kishte dhënë opinionin se "Aktiviteti i prokurimit nuk është në pajtim me rrethanat e përshkuara si emergjence ekstreme, gjegjësisht nuk është në pajtim me nenin 48.2 të Rregullorës për Prokurimin Publik". KRPP ka rekomanduar autoritetin kontraktues të analizojë dhe adresojë të gjithë faktorët që kanë sjell deri te përdorimi i kësaj procedure, po ashtu të vlerësojë të gjitha mundësitë që këtë aktivitet ta zhvillojë me procedure të hapur e cila do të rrishte transparencën, konkurrencën dhe trajtimin e barabartë për të gjitha palët e interesuara.</p> <p>Procedurat për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajse për IT" ishin zhvilluar përmes procedurës së negociuar me arsyetimin si blejje emergjente.</p> <p>Autoriteti kontraktues nuk kishte marrë për bazë opinionin e KRPP-së por kishte vazhduar aktivitetin e prokurimit përmes procedurës së negociuar e cila kishte rezultuar me nënshkrimin e kontratës me operatorin ekonomik me vlerë 15,288€.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme që zyrtarë përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për detyrimet kontingjente në mënyrë që prezantimi i tyre në Pasqyra Financiare Vjetore të jetë i saktë dhe i drejtë.</p>	Kryetari Drejtoria e administrates, zyra ligjore.	<p>Angazhimi I zyrës ligjore për implementimin e kësaj të gjeture Nderimi I një data baze të re për furnjen e të gjitha të dhënave në të pagesat euj.</p>	TM3-TM4 2023 Zbatuar
----	--	---	--	---	---	----------------------



11	Pranimi i shërbimeve para krijimit të urdhër blerjes	<p>kontingjente në PVF ishte për 81,843€. Dallimi është për arsye se komuna kishte prezantuar detyrime kontingjente edhe pse pagesa iu ishte bërë palëve.</p> <p>Shkak i shpalosjes jo të saktë të detyrimeve kontingjente ishte mos funksionimi i kontrolleve të brendshme në përditësimin e regjistrit të kontingjencave për rastet që janë kryer pagesat sipas vendimeve gjyqësore.</p>	Neni 22 i rregullës financiare nr.01/2013 Shpenzimi i parave publike, - procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhër blerje, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjell faturën për pagesë. <p>Në dy (2) pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 20,685€, kemi identifikuar se paraprakisht është pranuar fatura pastaj është krijuar urdhër blerje.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit të mirë të kontrollit të brendshëm.</p>	Kryetari duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës që të ndjekin hapat për procedimin e pagesave të përcaktuara me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike	Drejtorja e prokurimit, autorizuesit e buxheteve	Prokurimi dhe autorizuesit nga drejtoritë përkatëse të jenë në azhur në implementimin e të gjeturës.	TM3 TM4 2023	I zbatuar
----	--	--	---	---	--	--	--------------	-----------

12	Mos arrijta e verifikimit (inspektimi) 20% pronave e të paluajshme	<p>Bazuar në Ligjin nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajshme, respektivisht nën 15.2 përcakton se: Veprimtari i inspektues kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe vetëm kur është e nevojshme për parcelat.</p> <p>Komuna gjatë vitit 2022 nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin (inspektimin) e 20% të pronave të paluajshme sipas kërkesave të ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronat e paluajshme në fuqi. Ne kemi vërejtur se komuna ka bërë disa modifikime në sistemin e tatimit pronë, por nuk ka qenë në gjendje të na ofron dëshmi (formularë) të verifikimit të 20% të pronave të paluajshme. Gjatë këtij viti komuna kishte kryer verifikimin e vetëm 915 prej 10,850 objekteve sa janë në tërësi në territorin e Komunës apo 8.4%.</p> <p>Komuna ka pasur mungesë të anketuesëve në terren për verifikim (inspektim) të pronave, si dhe problemeve të vazhdueshme teknike me pajisjen GPS.</p>	<p>Kryetari dihet të sigurojë një rishikim të sistemeve ekzistuese për të konfirmuar nëse mekanizmat që ka vendosur për mbledhjen e të hyrave mund të funksionojnë në mënyrë efektive. Duhet të bëhet verifikimi (inspektimi) i pronave komunale siç parashihet me ligji në fuqi</p>	<p>Zyra e tatimit në pronë</p>	<p>Angazhimi i stafit, dalja në teren dhe verifikimi i objekteve dhe parcelave sipas ligjeve në fuqi.</p>	<p>TM3 TM4 2023  I Zbatuar</p>
----	--	--	--	--------------------------------	---	--



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA SHTIME**  
**OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**



**Drejtoria për Buxhet dhe Financa**  
**Direktorat za Budžet i Finansije**

Data/Datum/Date:	21.02.2024
Nr./Br./No	11/33
Për/Za/To:	Komitetin për Politikë dhe Financa- Kuvendit Komunal Shtime
Përmes/Preko/Through:	Qemajl Aliu- Kryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Besnik Ahmeti- Drejtor i Financave Komuna Shtime Kimete Ukaj, Zyrtar Kryesor Financiar
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim për Ndarjen e të Hyrave të Bartura nga viti 2023 në vitin 2024

Të nderuar/a

Bazuar në Ligjin me Nr.03/L-48 për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, neni 27 dhe Ligji Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, neni 30 të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal 2023 skadojnë në mesnatën e 31 dhjetorit 2023, me përjashtim të ndarjeve buxhetore të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të komunave, apo të ndonjë OB-je tjetër të lejuara me këtë ligj, të cilat barten në vitin vijues.

Përmes kësaj shkresë po ju dorëzojmë propozimet për ndarjen e të hyrave të vitit 2023, të cilat barten për shpenzim në vitin 2024. Propozimet janë të përshkruar në formë tabelar sipas kufizimeve kontabel/financiarë buxhetor: Kodi i OB, Programi Buxhetor, Kodin e projektit, dhe si kufizim kryesor Kodin ekonomik të shpenzimit në programe të cilat nuk janë përmbushur në vitin 2023 dhe në projektet e miratuara me buxhet për vitin 2024 (jo projekte të reja) si në tabelat në vazhdim:

Nr.	Kodi OB	Kodi Ekonomik	Kodi i propozuar i programit për vitin 2023	Kodi i projektit në vitin 2024	Programi Buxhetor	Emërtimi i projektit	Ndryshimi i propozuar për vitin 2024 në €
1	617	30	163(16307)	53480	Administrata dhe Personeli	Blerja e veturave për Administratën Komunale Shtime	80,000.00€
		30	660(66340)	53557	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Projektet me bashkefinancim (Ministri dhe Organizata të ndryshme buxhetore)	20,000.00€

2		13	660(66340)		Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Mallra dhe Sherbime	60,000.00€
3		13	180(18451)		Menaxhimi i katastrofave Natyrore	Mallra dhe Sherbime	227,050.00€
4		13	920(93180)		Arsimi Fillor	Mallra dhe Sherbime	32,000.00€
5		13	920(94380)		Arsimi i Mesëm	Mallra dhe Sherbime	20,331.29€
6		13	920(92330)		Arsimi Parashkollor Qerdhja	Mallra dhe Sherbime	5,460.77€
7		13	755(75531)		Sherbimet Sociale	Mallra dhe Sherbime	4,000.00€
8		13	730 (73450)		Shendetsia Primare	Mallra dhe Sherbime	10,000.00€
9		13	180(18411)		Zjarrfikësit dhe Inspektimet	Mallra dhe Sherbime	20,000.00 €
12		20	730(73016))		Administrata Shendetesi	Subvencione dhe Transfere	4,000.00€
13		20	480(48007)		Zhvillim Ekonomik	Subvencione dhe Transfere	34,700.00€
14		20	850(85007)		Shërbimet kulturore	Subvencione dhe Transfere	30,000.00€
15		20	470(47047)		Zhvillimi dhe Inspektimi Bujqësor	Subvencione dhe Transfere	36,211.00€
16		20	755(75531)		Sherbimet Sociale	Subvencione dhe Transfere	45,000.00€
						<b>Gjithsej</b>	<b>628,753.06€</b>

## Arsyetim:

Në bazë të Propozimit për Ndarjen e të Hyrave të Bartura nga vitit 2023 në vitin 2024 kemi bërë ndryshimin (rritje) në strukturën e kategorive të shpenzimeve kemi rritur kategorin e Mallrave dhe Sherbimeve për 356,243.57€, kategoria e subvencioneve dhe transfereve e rritur për 109,024.14 dhe për shpenzimet kapitale nuk kemi rritje për mbulimin e aktiviteteve të planifikuara sipas drejtorisë ku janë ato më të nevojshme pasi kemi pasur tejkallim të kufirit të të hyrave vetanake për 448,923.35€ gjatë vitit 2023, të hyrat e pa shpenzuara të vitit 2023 (fondi 21) janë 100,738.18€ ndërsa të pa shpenzuara të hyrat e vitit 2022 (fondi 22) janë 79,091.53 € ku në total shuma për bartje është 628,753.06€

Në vitin 2023 shuma e mjeteve të pashpenzuara e fondit 21 është 100,738.18€ dhe shuma fondi 22 është 79,091.53 € ku tejkallimi i kufirit të të hyrave vetanake është 448,923.35€ pra total shuma për bartje është 628,753.06€ ku janë të planifikuara në kategorinë ekonomike Mallra dhe Sherbime shuma prej 378,842.06€ në ato nën programe të cekura në kërkesë për mbulimin nevojave të tyre dhe obligimeve si pasojë e rritjes së çmimeve ( blerja e druve, mirembajtja e objekteve, furnizime të ndryshme, blerja e barnave etj).


Në kategorinë ekonomike subvencionet dhe transferet shuma 149,911€ është e planifikuar në nën programin Zhvillimi dhe Inspektimi Bujqësor për mbulimin e shpenzimeve të fermerëve si dhe në nën programin Sherbimet Kulturorë për financimin e klubeve sportive ku kërkesat e tyre kanë qenë në shumë më të larta se shuma e ndarë me buxhet, Zhvillim Ekonomik, Sherbimet Sociale, Administrata Shendetesi për pagesën e nënave lehonave.

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale shuma është 100,000.00€ e planifikuar në projektet e vitit 2023 ku ende nuk i kemi lidhur kontratat, pra projektet gjenden në fazën e tenderimit.

Me respekt!




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E SHTIMES  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim  
Uprava za Obrazovanje/Department of Education

Data	12 shkurt 2024
Nr	05/65
Për	z. Adnan Ademi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes
Nga	Yllka Fejzullahu, drejtoreshë e Drejtorisë Komunale të Arsimit
Lënda	<b>INFORMATË NGA DKA PËR PËRFUNDIMIN E GJYSMËNJETORIT TË PAR SHKOLLOR 2023/2024</b>



Në të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Shtimes, synimi i përgjithshëm i DKA-së, ka qenë dhe mbetet, ngritja e cilësisë në procesin edukativo-arsimor, përmirësimi i infrastrukturës, ngritja profesionale e personelit arsimor, zhvillimi dhe zbatimi i aktiviteteve pedagogjike, administrative, juridike dhe financiare.

Drejtoria Komunale e Arsimit, në bashkëpunim me drejtorët e institucioneve-edukativo-arsimore ka bërë përgatitjet e duhura për fillimin e vitit shkollor 2023/2024, kemi punuar me intensitet të shtuar për realizimin punëve dhe detyrave që kemi pasur, në bashkëpunim të ngushtë me drejtorët e shkollave, mësimmhënësit, nxënësit e prindërit.

Numri i nxënësve të regjistruar në klasën e parë dhe përgatitore, në vitin shkollor 2023/2024

Shkolla	Vendi	Klasa e parë			Klasa përgatitore		
		M	F	Gj	M	F	GJ
"Abdullah Shabani"	Carralevë	10	8	18	11	2	13
	Zborc	6	8	14	6	4	10
"Bajram Curri"	Petrovë	19	19	39	18	13	31
	Mollopolc	5	5	10	1	2	3
"Emin Duraku"	Shtime	68	59	127	48	53	101
	Belinc	2	5	7	5	2	7
	Lagje	6	5	11	5	5	10
	Davidovc	8	5	13	4	8	12
"Hasan Prishtina"	Godanc	14	18	32	17	12	29
"Idriz Ajeti"	Pjetërshticë	9	13	22	11	10	21
"Lasgush Poradeci"	Muzeqinë	7	7	14	7	3	10
	Gjurkovc	4	2	6	5	7	12
	Vojnovc	7	6	13	2	7	9
	Rashincë	7	12	19	5	5	10
	Gllavicë	2	1	3	2	3	5
"Skënderbeu"	Reçak	11	7	18	11	6	17
<b>Gjithsej:</b>		<b>185</b>	<b>180</b>	<b>365</b>	<b>158</b>	<b>142</b>	<b>300</b>

**PËRFUNDIMI I GJYSMËVJETORIT TË PARË DHE SUKSESI I NXËNËSVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

Gjysmëvjetori i parë ka filluar me 1 shtator 2023 dhe ka përfunduar më 12 janar 2024 në të gjitha shkollat e komunës së Shtimes. Institucionet shkollore kanë kompletuar suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të këtij viti shkollor.

Në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, bëjnë pjesë gjithsej 7 shkolla amë me 9 paralele të ndara fizike, ku mësimin, në vitin shkollor 2023/24, e vijojnë 3442 nxënës, të shpërndarë në 176 paralele. Në nivelin e arsimit fillor, I-V, janë 1901 nxënës, të shpërndarë në 102 paralele, ndërsa në nivelin e arsimit të mesëm të ulët, VI-IX, janë gjithsej 1541 nxënës, të shpërndarë në 74 paralele.

Në këtë numër, të përgjithshëm të nxënësve, nuk janë përfshirë 339 fëmijë të nivelit parafillor (22 paralele).

Ndërkaq, në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, X-XII, janë gjithsej 957 nxënës, të shpërndarë në 48 paralele.

### Suksesi i nxënësve në nivelin e parë të arsimit (I-V)

Në nivelin fillor të arsimit, kalueshmëria e nxënësve është: **1843** nxënës me sukses pozitiv, **48** me sukses të pamjaftueshëm dhe **10** nxënës të panotuar, gjegjësisht:

- Me sukses të shkëlqyeshëm janë: 1060 nxënës ose 52.82 për qind
- Me sukses shumë të mirë janë: 399 nxënës ose 22.66 për qind
- Me sukses të mirë janë: 291 nxënës ose 15.28 për qind
- Me sukses të mjaftueshëm janë: 93 nxënës ose 5.28 për qind
- Me sukses të pamjaftueshëm janë: 48 nxënës ose 2.92 për qind
- Të panotuar janë: 10 nxënës ose 0.59 për qind

### Suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2023/24 – Niveli i arsimit fillor (I-V)

Emri i shkollës	Nr. i pambllojeve	Nr. i nxënësve			Kategoria klasën me sukses								Përcillten		Të pa notuar		Gjithsej orë gjatë vitit		Nota mesatare
					Shkëlqyeshë		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshë		Me nota negative				Të planifikuara	Të mbajtura	
					Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%					
1 "A. Shabani"	2	62	64	126	61	48.41	28	22.22	23	18.25	9	7.14	3	2.38	2	1.59	3963	3864	4.1
2 "B. Curri"	15	120	111	231	127	54.98	55	23.81	28	12.12	12	5.19	9	3.90	0	0.00	5931	5759	4.22
3 "E. Duraku"	40	425	412	837	492	58.78	157	18.76	137	16.37	38	4.54	13	1.55	0	0.00	15841	15472	4.19
4 "H. Prishtina"	10	103	95	198	98	49.49	45	22.73	31	15.66	7	3.54	14	7.07	3	1.55	4491	4153	4.23
5 "I. Ajeti"	5	52	53	105	52	49.52	35	33.33	10	9.52	7	6.67	0	0.00	1	0.95	1992	1940	4.26
6 "L. Poradeci"	25	152	130	282	172	60.99	58	20.57	34	12.06	14	4.96	4	1.42	0	0.00	10065	9995	4.24
7 "Skënderbeu"	5	71	51	122	58	47.54	21	17.21	28	22.95	6	4.92	5	4.10	4	3.28	1964	1958	3.9
<b>Gjithsej:</b>	<b>102</b>	<b>985</b>	<b>916</b>	<b>1901</b>	<b>1060</b>	<b>52.82</b>	<b>399</b>	<b>22.66</b>	<b>291</b>	<b>15.28</b>	<b>93</b>	<b>5.28</b>	<b>48</b>	<b>2.92</b>	<b>10</b>	<b>1.05</b>	<b>44247</b>	<b>43141</b>	<b>4.16</b>

### Suksesi i nxënësve në nivelin e dytë të arsimit (VI-IX)

Në nivelin mesëm të ulët të arsimit, kalueshmëria e nxënësve është: **1097** nxënës me sukses pozitiv, **424** me sukses të pamjaftueshëm dhe **20** nxënës të panotuar, gjegjësisht:

- Me sukses të shkëlqyeshëm janë: 362 nxënës ose 23.89 për qind
- Me sukses shumë të mirë janë: 337 nxënës ose 23.45 për qind
- Me sukses të mirë janë: 325 nxënës ose 20.26 për qind
- Me sukses të mjaftueshëm janë: 73 nxënës ose 4.08 për qind
- Me sukses të pamjaftueshëm janë: 424 nxënës ose 26.39 për qind
- Të panotuar janë: 20 nxënës ose 1.93 për qind



**Suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2023/24 – Niveli i arsimit të mesëm të ulët (VI-IX)**

Emri i shkollës	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve		Kaluan klasën me sukses								Kanë përsëritur klasën		Të pa notuar		Gjithsej orë gjatë vitit		Nota mesatare	
				Shkëlqyeshëm		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative				Të planifikuara	Të mbajtura		
				Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%						
1 "A. Shabani"	2	51	55	106	31	29.25	21	19.81	10	9.43	5	4.72	37	34.91	2	1.89	4185	3367	3.50
2 "B. Curri"	12	82	102	184	48	26.09	38	20.65	39	21.20	8	4.35	51	27.72	0	0.00	6181	5651	3.37
3 "E. Duraku"	28	323	327	650	141	21.69	122	18.77	135	20.77	29	4.46	217	33.38	6	0.92	14766	13286	3.13
4 "H. Prishtina"	8	85	77	162	24	14.81	46	28.40	31	19.14	5	3.09	53	32.72	3	1.85	4605	3190	3.29
5 "I. Ajeti"	4	43	38	81	23	28.40	21	25.93	18	22.22	0	0	16	19.75	3	3.70	2092	1783	3.62
6 "L. Poradeci"	16	148	104	252	78	30.95	61	24.21	69	27.38	23	9.13	20	7.94	1	0.40	9680	9525	3.67
7 "Skënderbeu"	4	60	46	106	17	16.04	28	26.42	23	21.70	3	2.83	30	28.30	5	4.72	2085	1950	3.28
<b>Gjithsej:</b>	<b>74</b>	<b>792</b>	<b>749</b>	<b>1541</b>	<b>362</b>	<b>23.89</b>	<b>337</b>	<b>23.45</b>	<b>325</b>	<b>20.26</b>	<b>73</b>	<b>4.08</b>	<b>424</b>	<b>26.39</b>	<b>20</b>	<b>1.93</b>	<b>43594</b>	<b>38752</b>	<b>3.41</b>

**Suksesi i nxënësve në nivelin e tretë të arsimit (X-XII), përkatësisht në Gjimnazin "Naïm Frashëri" dhe në Institucionin e Arsimit dhe Aftësisit Profesional**

Në nivelin mesëm të lartë të arsimit, kalueshmëria e nxënësve është: **428** nxënës me sukses pozitiv, **487** me sukses të pamjaftueshëm dhe **42** nxënës të panotuar, gjegjësisht:

- Me sukses të shkëlqyeshëm janë: 116 nxënës ose 16.35 për qind
- Me sukses shumë të mirë janë: 160 nxënës ose 16.35 për qind
- Me sukses të mirë janë: 123 nxënës ose 12.62 për qind
- Me sukses të mjaftueshëm janë: 29 nxënës ose 3.17 për qind
- Me sukses të pamjaftueshëm janë: 487 nxënës ose 51.12 për qind
- Të panotuar janë: 42 nxënës ose 4.53 për qind

**Suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2023/24 – Niveli i arsimit të mesëm të lartë (X-XII)**

Emri i shkollës	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve		Kaluan klasën me sukses								Kanë përsëritur klasën		Të pa notuar		Gjithsej orë gjatë vitit		Nota mesatare	
				Shkëlqyeshëm		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative				Të planifikuara	Të mbajtura		
				Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%						
1 "N. Frashëri"	23	232	293	525	59	11.24	106	20.19	79	15.05	9	1.71	256	48.76	16	3.05	11928	11107	2.95
2 IAAP	25	252	180	432	57	13.19	54	12.50	44	10.19	20	4.63	231	53.47	26	6.02	13704	13013	2.83
<b>Gjithsej:</b>	<b>48</b>	<b>484</b>	<b>473</b>	<b>957</b>	<b>116</b>	<b>12.22</b>	<b>160</b>	<b>16.35</b>	<b>123</b>	<b>12.62</b>	<b>29</b>	<b>3.17</b>	<b>487</b>	<b>51.12</b>	<b>42</b>	<b>4.53</b>	<b>25632</b>	<b>24120</b>	<b>2.89</b>

Me këtë rast, po i listojmë disa nga aktivitetet kryesore të realizuara gjatë kësaj periudhe kohore:

- ✓ Gjatë këtij viti janë pensionuar 18 punonjës në sektorin e arsimit, kurse 14 mësimdhënësve kemi pasur në pushim të lehonisë dhe 2 të tjerë në pushim pa pagesë.
- ✓ Kemi mbajtur takime të rregullta me drejtorë të shkollave;
- ✓ Është bërë hormanizimi dhe plotësimi i orëve mësimore të mësimdhënësve;
- ✓ Në komunën e Shtimes janë renovuar pesë shkolla në vlerë 135.000 euro si: SHFMU "Emin Duraku" në Shtime, SHFMU "Bajram Curri" në Petrovë, SHFMU "Hasan Prishtina" në Godanc, si dhe në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Shtime. Në këto shkolla është bërë lysterja e objekteve, rregullimi toaleteve, kulmeve si dhe sanime tjera ku ka pasur nevojë.
- ✓ Në kuadër të projekti "TAKE" në vlerë 21.000 euro, projekt ky që së bashku me Caritasin Zviceran dhe participim të Komunës së Shtimes, pesë institucione arsimore të komunës përfituan inventarë dhe pajisje didaktike për klasat parafillore. Përmes kësaj projekti, kanë përfituar paisje didaktike dhe inventarë shkolla e Shtimes, Reçakut, Vojnocit, Pjetërshiticës dhe Godancit.
- ✓ Me datë 4 shtator 2023, në prani të shumë mysafirëve, kryetarit të komunës së Shtimes, drejtoreshës së Arsimit është bërë inagurimi i shkollës së re ShFMU "Abdullah Shabani" Carralevë me të gjitha kapacitetet e nevojshme për të rritur cilësinë në arsim, ambien modern, hapësirë shumë e madhe për të zhvilluar aktivitetet të shumta.
- ✓ Me datë 3 tetor 2023 - Gjimnazi "Naim Frashëri" dhe Institucioni i Arsimit dhe Aftësimin Profesional kanë filluar ditën e parë të eskursionit të maturantëve, duke bërë vizitën e parë në qytetin e Lezhës, dita e dytë me datë 4 tetor 2023 e eskursionit të maturantëve vazhdoi në dy qytetet e bukur atë të Krujës dhe qytetin e vjetër të Durrsit, dita e tretë me datë 5 tetor 2023 vizituan qytetin e bukur të Vlorës, ndërsa me datë 6 tetor 2023 ShML "Naim Frashëri" dhe LAAP janë vizituar nga zyrtarët komunal të Shtimes si dhe nga kryetari i komunës së Shtimes z. Qemajl Aliu si dhe nga drejtorsha e Arsimit Yilka Fejzullahu.
- ✓ Me datë 16 Tetor në Ditën Botërore të Ushqimit në ShFMU "Abdullah Shabani" është mbajtur aktivitet në lidhje me këtë ditë ku nxënësit në bashkëpunim me prindërit kishin përgatitur produkte ushqimore. Këto produkte janë blerë nga nxënësit e shumta e mbledhur nga ky aktivitet janë dhuruar për një familje me nevojë në Zborcë në vlerë mbi 200 euro.
- ✓ Me 20 tetor 2023 - Në Godanc është vënë gurthemeli për ndërtimin e një çerdheje publike në vlerë prej 414.643.49 mijë eurosh. Me rastin e vendosjes së këtij gurthemeli ishte i pranishëm kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci dhe kryetarin e komunës së Shtimes, Qemajl Aliu me bashkëpunëtorë si dhe banorë të fshatit Godanc. Ky projekt i MASHTI-it ka vlerën e përgjithshme 414.643.49 €, kurse sipërfaqja e përgjithshme e objektit do të jetë 756 metra katrorë. Çerdhja në fjalë, do të ketë pesë klasa për fëmijë të grup-moshave 9 muaj deri 5 vjeç, kuzhinën, banjot, zyrën e takimeve, zyrën e mjekut e infermieres, holl të gjerë për

- aktivitete, lavanderi, depo, terasat, ashensorë etj. Me këtë projekt janë paraparë 72 shtretër për të gjitha grup-moshat e fëmijëve.
- ✓ Në vazhden e projekteve të shumta në institucionet arsimore në komunën e Shtimes është realizuar projekti "TAKE" në vlerë 21.000 euro, projekt ky që së bashku me Caritasin Zviceran dhe participim të Komunës së Shtimes. Pesë institucione arsimore të komunës përfituan inventarë dhe pajisje didaktike për klasat parafillore. Përmes kësaj projekti, kanë përfituar paisje didaktike dhe inventarë shkolla e Shtimes, Reçakut, Vojnovcit, Pjetërshiticës dhe Godancit.
  - ✓ Më 25 nëntor është mbajtur Gara Komunale e Matematikës - Në Olimpiadën Matematike Komunale të mbajtur, më 25 nëntor 2023, në Shtime janë përzgjedhur nxënësit e komunës së Shtimes për pjesëmarrje në Olimpiadën XV Matematike të Kosovës (OMK) që do të mbahet më 23 dhjetor 2023, në Prishtinë, ku u kualifikuan trembëdhjetë nxënës për garën Republikane të Matematikës.
  - ✓ Në muajin nëntor me rastin e 28 Nëntorit në të gjitha shkollat e komunës së Shtimes janë mbajtur programe artistike nga nxënësit e secilës shkollë, kanë përgatitur aktivitetet të shumta me nxënës, duke filluar nga filma dokumentarë, ushqime tradicionale, poezi e proza, e deri te veshjet kombëtare.
  - ✓ Nga data 7 nëntor 2023 ka filluar të aplikohet projekti me mbështetjen e Këshillit drejtues të shkollës, Këshillit të prindërve, Këshillit të nxënësve e Këshillit të klasave "Pa telefona gjatë procesit mësimor" në Gjimnazin "Naim Frashëri" në Shtime. Ky projekt do të realizohet me qëllim të zbatimit sa me efikas të vendimit të MASHT nr 509/01B, të datës 29.11.2018 dhe "Udhëzimit Administrativ nr 20/2018, për ndalimin e telefonave celular në institucionet parauniversitare", ku gjatë vikendit është bërë montimi i dollapëve nëpër secilën klasë për vendosjen e telefonave celular gjatë periudhës së qëndrimit në shkollë.
  - ✓ Me datë 7 nëntor, Gjimnazi "Naim Frashëri" ka bërë hapjen e Ofertës "Furnizim me uniforma shkollore për nxënësit, mësimdhënësit dhe stafin Teknik të shkollës.
  - ✓ HOUR OF CODE - Në kuadër të Javës së Kodimit, shkolla ShF "Emin Duraku" Shtime së bashku me Andy Moxon, ka realizuar me shumë sukses Javën e Kodimit. Në këtë aktivitet gjatë dy javëve, kanë marrë pjesë pothuajse 400 nxënës nga klasat III, IV dhe V. Planifikojmë që këtë aktivitet ta realizojmë edhe në paralelet e ndara në Davidovc, Lagje dhe Belinc.
  - ✓ Organizata BSFK së bashku me ShF "Emin Duraku", ka organizuar sesion informues me prindërit e komunitetit për regjistrimin e fëmijëve në klasën parafillore dhe në klasën e parë. Po ashtu janë realizuar një sërë aktivitetesh jashtëkurrikulare dhe vizita studimore me nxënës të komuniteteve dhe në bashkëpunim me nxënësit e tjerë.
  - ✓ Në muajin nëntor në kuadër të sigurisë së nxënësve janë mbajtur takime pune me KSPL, ku në bashkëpunim me ta dhe OSCE është fituar një projekt prej 8.000 euro për paisje me kamera në paralelet e shkollës ShFMU "Lasgush Poredeci" paralele këto: Muzeqinë, Gjurkoc dhe Vojnoc.
  - ✓ Me 16 shtator 2023 - në garën e robotikës KOSOVA MAKERS LEAGUE ekipi i ShFMU "Lasgush Poredeci" paralelja e ndarë në Rashincë kanë marrë pjesë në Super Finalen e Garës së Robotikës.
  - ✓ Me datë 10 nëntor 2023 është mbajtur një ligjeratë nga zyrtarët policor në ShFMU "Abdullah Shabani" Carralevë me nxënësit e klasës së parë, ligjeratë kjo me temë


- "Siguria e qarkullimit të këmbësorëve në komunikacionin rrugor" ku në këtë rast nxënësit janë informuar me rregullat bazike të lëvizjes së këmbësorëve në komunikacionin rrugor dhe në fund janë paisur me vizore në të cilat janë të shkruara disa rregulla të komunikacionit dhe disa gjëra me reflektim që do t'i vendosin në çantat dhe trupin e tyre gjatë lëvizjes, ku ato shënja reflektojnë me ngjyrë të gjelbërt dhe do të jenë lehtë të dukshme për ngasësit në trafik.
- ✓ Në lidhje me fushatën globale "16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore", ministria e drejtesise organizon aktivitete për senzibilizimin e qytetarëve të vendit për parandalimin e dhunës në familje, zyrtarë policor kanë mbajtur ligjerata në këto shkolla: ShFMU "Idriz Ajeti" Pjetërshiticë, ShFMU "Abdullah Shabani" Carralevë dhe në Zborc, këto ligjerata janë bërë në fund të muajit nëntor.
  - ✓ Në muajin nëntor 2023 – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Dr. Vezir Bajrami" ka njoftuar se ka nisur procesin e vaksinimit për nxënësit e shkollave të komunës së Shtimes. vaksinimi i rregullt për nxënësit e klasave të para (I) dhe dymbëdhjeta (XII), ku janë vaksinuar gjithsej 578.
  - ✓ Në ShFMU "Lasgush Poradeci" në Muzeqinë janë zhvilluar Garat e Shahut pëe nxënës të nivel 6 deri 9.
  - ✓ Më date 18.12.2023 janë zhvilluar Garat Komunale të Ping Pongut me nxënës të dy niveleve të shkollimit, niveli 6-9 dhe niveli 10-12.

#### PROJEKTET PËR VITIN 2024 NGA MASHTI DHE BUXHETI KOMUNAL

- Ndërtimi i shkollëve për Gjinnazin "Naim Frashëri" në Shtime (Rr. "Isa Boletini") (Faza dytë) në vlerë 38.000 €
- Renovimi i shkollës së Petrovës, Emin Durakut, Lagje Pajtimit, Belincit dhe Naim Frashëri 50.000 €
- Rregullimi i oborreve dhe rrethojave të shkollave: Carralevë, Gjyrkoc, IAAP, Davidoc dhe Çerdhe 20.000 €
- Funkcionalizimi i sallave të Edukatës Fizike: Muzeqinë, Carralevë dhe Petrovë 14.150€
- Gjeneratori i ShFMU "Abdullah Shabani" Carralevë 10.000 €
- Ndërtimi i Observatorit dhe Planetariumit të parë në Kosovë në Rashincë (Faza Dytë) 50.000 €
- Ndërtimi i aneksit në Petrovë dhe renovimi i shkollës aktuale (MASHTI)
- Renovimi i Çerdhës së Vjetër në Shtime 100.000 €
- Funkcionalizimi i Çerdhës në fshatin Muzeqinë (MASHTI)
- Ndërtimi i Sallës së Edukatës Fizike në Godanc- SHFMU "Hasan Prishtina" (MASHTI)
- Ndërtimi i Çerdhës së Fëmijëve në Petrovë (MASHTI)
- Ndërtimi i Çerdhës së Fëmijëve në Godanc (MASHTI)
- Renovimi i ShFMU "Lasgush Poradeci" paralelja e ndarë në Vojnoc (MASHTI)



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KUVENDI KOMUNAL / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY**  
**SHTIME / ŠTIMLJE**



Data/Datum/Date:	16.02.2024
Nr./Br./No:	02/ 94
Për/Za/To:	Kuvendi i Komunës-Shtime, Kryesuesi Z. Adnan Ademi
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	Zyra e Kryetarit të Komunës së Shtimes, Z. Qemajl Aliu
Lënda/Predmet/Subject :	Prop-Vendim për caktimin e çelësit të zgjedhjes së komisioneve për ndarjen e çmimeve, "Sakrificat Reçakut-1999" dhe "Pena e Artë"

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Shtimes;

Në mbështetje të nenit 10 të Rregullores Komunale Npi-01/173 të dates 27.05.2009 për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet, si dhe të nxitur nga nevoja e ndarjes së dekoratave për personalitetet e ndryshme që kanë dhënë kontribut domethënës, propozojmë fillimin e procedurës për ndarjen e çmimeve për ti nderuar këto personalitete nga Komuna e Shtimes. Në mbështetje të procedurës sipas dispozitave të kësaj rregullore, ju ftoj të miratoni këtë Propozim-vendim që përcakton strukturën e komisioneve përgjegjëse për vlerësimin e dhënies së çmimeve "Sakrificat Reçakut-1999" dhe "Pena e Artë" për personalitetet e shquara që mund të jenë përfitues të këtyre çmimeve sipas kësaj Rregullore.

**Struktura komisionit për ndarjen e çmimit "Sakrificat Reçakut-1999", propozojmë si vijon:**

- 2 Anëtarë nga Kuvendi Komunal - Pozitë 1 dhe Opozitë 1,
- 1 Anëtar - nga Shoqëria Civile,
- 1 Anëtar - nga Ekzekutivi i Komunës së Shtimes,
- 1 Anëtar - nga Shoqatat e Dala nga Lufta e UÇK-së.

**Struktura komisionit për ndarjen e çmimit "Pena e Artë", propozojmë si vijon:**

- 2 Anëtarë nga Kuvendi i Komunës - Pozitë 1 dhe Opozitë 1,
- 2 Anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës së Shtimes,
- 1 Nga Shoqëria Civile – (nga fusha e arsimit ose kulturës).


Ju ftojme që ti miratoni këto dy struktura të përbërjes së Komisioneve, që e funksionalizojnë procedurën e ndarjes së këtyre çmimeve.

Ju faleminderit!

Adresa: Rr. Tiranës, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.  
 Tel.: +381290389016, email: info@shtime-komuna.org  
<http://kk.rks-gov.net/shtime>



REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SHTIMES  
MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE



**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**


/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Data/Datum/Date:	16 shkurt 2024
Nr./Br./No	02/90
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Shtimes
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	Vlora Hyseni, zyrtare për Komunikim me Publikun
Lënda/Predmet/Subject:	<b>Propozimet nga konsultimi publik me qytetarë</b>

Në konsultimin publik të organizuar më 15. 2. 2024, në sallën e Kuvendit të Komunës së Shtimes për Draft-Rrogulloren Komunale për Transparencë dhe Planin e Veprimit për Transparencë 2024-2028 janë dhënë këto propozime:

- Tek neni 5, paragrafi a ku thuhet: Zyra për Komunikim me Publikun njofton mjetet e informimit publik 2 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve duhet të jetë: Kryesuesi i Kuvendit ose Komitetit, përmes Zyrës për Komunikim me Publikun, publikon njoftimin për mbledhje së paku 7 (shatë) ditë pune para mbledhjeve të rregullta, 3 (tre) ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme, si dhe brenda ditës për mbledhjet urgjente.
- Te i njëjtin nen, veçse te paragrafi b, ku thuhet: Të gjitha propozimet e komiteteve duhet të jetë: Të gjitha procesverbalet dhe raportet kurse fjala propozimet të hiqet.
- Te neni 8, pika 1. Rregulloret dhe dokumentet me interes të përgjithshëm të Komunës i nënshtrohen diskutimit publik duhet të jetë konsultimit publik, ndërsa fjala diskutimit të hiqet.
- Përsëri te neni 8, pika 3, ku thuhet: Njoftimi publik, sipas paragrafit të 8.2 të këtij neni, duhet të përmbajë datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të paraparë për atë mbledhje, duhet të jetë: Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt-propozimit në bashkëpunim me zyrtarin për konsultime publike njofton palët e interesuara për konsultimin me shkrim dhe elektronik. Njoftimi me shkrim dhe elektronik, përmban: Projekt-Propozimin për të cilin kërkohen komentet, adresën e saktë ku duhet të dërgohen komentet me shkrim dhe elektronike, informatat (emrin, mbiemrin dhe e-mailin) për personin përgjegjës për pranimin e komenteve dhe afatin për dorëzimin e komenteve.



- Te neni 8, pika 5 e kemi edhe një ndryshim ku thuhet: Propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve, duhet të evidëncohen. Propozimet shqyrtohen brenda 15 ditëve nga përfundimi i konsultimeve, duhet të jetë: Afati për përgatitjen e Raportit është më së paku pesëmbdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarike, për projekt-propozimin që nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim.
- Te neni 9, ku thuhet: Përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është propozuesi i dokumentit të caktuar dhe njësia/zyrtari për komunikim publik, duhet të jetë: Përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është propozuesi i dokumentit të caktuar së bashku me zyrtarin përgjegjës për konsultime publike në koordinim me Zyrën për Komunikim me Publikun, kurse pjesa dhe njësia/zyrtari për komunikim publik hiqet krejt.
- Ndërkaq te Dokumentet për Konsultim Publik, fq. 6, përkatësisht te neni 11, pika 1.1. ku thuhet: Projekt-Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës/ekzekutivit (Kjo pjesë duhet hiqet krejt).
- Te neni 18, pika 3, ku thuhet: Aktet normative dhe vendimet e organeve të komunës dërgohen në njësinë përgjegjëse për publikim në faqen zyrtare të komunës në formën elektronike, në gjuhët zyrtare dhe në formatin e përcaktuar nga njësia/zyrtari përgjegjës/e për publikim të aktit normativ dhe vendimet e organeve të komunës, duhet të jetë: Aktet dhe dokumentet nga paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij neni publikohen nga njësia përgjegjëse për komunikim në komunë, në formë elektronike, në pajtim me dispozitat e legjislacionin, përkatësisht Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.
- Kurse tek Draft-Plani i Veprimit për Transparenë, gjegjësisht te Korniza Ligjore për Transparenë, fq. 5, duhet të hiqet krejt pjesa ku shkruan: Rregullore Nr.02/2012/MF për Tarifat në Qasje në Dokumente Publike.



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
 Nr.01-060/01-2466/24 datë: 22.01.2024



Npi – 01/48 datë: 31.01.2024

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 31.01.2024, është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**P R O C E S V E R B A L**

**I M B L E D H J E S Ë I - T Ë R R E G U L L T T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S S Ë S H T I M E S**  
 E thirrur për datën: 31.01.2024, (e mërkurë) në ora 09.<sup>00</sup> h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Reshat Mujota, dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Drejtorët, Shefja e Kabinetit - znj.Anita Kurti, ZKF-znj.Kimete Ukaj, RZSH - Muhamet Hoxha, Asistente e Kryesuesit - znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët e IT-së, Zyrtare e Informimit - znj.Vlora Hyseni dhe praktikantët, znj.Valmira Hoxha, znj.Sadbere Halili dhe znj.Donjeta Qorrolli.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**R E N D I T E**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 15.12.2023,
2. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2024,
3. Raport Vjetor Buxhetor (shpenzimet) për vitin 2023,
4. Draft-Rregullore për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes (Pas diskutimit Publik),
5. Draft-Rregullore Komunale për Transparencë, (për diskutim publik),
6. Draft-Plani i veprimit për transparencë komunale 2024-2028, (për diskutim publik),
7. Raport i Punës së Kuvendit për vitin 2023,
8. Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për ndarjen e titujve të nderit,
9. Draft- Programi Strategjik për ujërat në Komunën e Shtimes, (pas diskutimit publik)
10. Propozim-Vendim për ndarjen e subvenc. për nënat Lehona për fëmijët e lindur në vitin 2024,
11. Propozim-Vendim për Inicimin e procedurës të themelimit të Ndërrmarrjes Publike Lokale për kryerjen e shërbimeve publike në Komunën e Shtimes.
12. Raport i Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023,
13. Pyetje – Përgjigje,
14. Informatë nga Drejtoria për Administratë për vitin 2023.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për rendin e ditës.

**z.Rexhep Gashi;** Përshëndetje, nuk pajtohem me rendin e ditës, sepse pika pyetje-pergjigje duhet të jetë si pikë e dytë e rendit të ditës. Arsyeya është se drejtorat nuk po janë prezent as në mënyrë



fizike, dhe nuk po i kthejnë përgjigjet, dhe në fund po shihet që nuk janë drejtorat prezent në mbledhje.

**z.Hasan Avdyli;** Përshëndetje, sa i përket rednit të ditës, unë e propozoj një pikë shtesë, që të shqyrtohet kërkesa e humanistit Ramiz Kadriu, e që besoj e keni marrë këtë kërkesë. Ju ftoj ta mbështesni këtë donacion.

**z.Besnik Seferi;** Përshëndetje, po ndërlidhem me propozimin e parafolsit, e di kërkesën e tij edhe e kam pa. Kërkoj që kërkesa të specifikohet mirë në detaje dhe pastaj ne ta shqyrtojmë. Prandaj unë nuk mendoj që duhet të diskutohet sot për atë kërkesë pa u sqaruar gjërat mirë.

**z.Kadri Emini;** Përshëndetje, i urojë detyrën e re drejtorit të Bujqësis z.Gojart Bajramit suksese. Te rendi i ditës është një kërkesë nga Davidovci për një parcelë për destinimin e saj për varreza, unë kërkoj që pengesën ligjore ta bëjë publike drejtori i DPUKGI-së dhe të diskutohet në Kuvend. Edhe kërkesa e Ramiz Kadriut të specifikohet edhe pastaj të vjen në Kuvend. Jam për këtë rend dite.

**z.Përparim Ramusa;** Sa më kujtohet ju Kryesues keni premtu që ka me qenë pika e dytë mbaje premtimin. Kuvendi duhet të diskutojë edhe nëse ka pengesa ligjore as ne nuk jemi me miratim me pengesa ligjore. Jemi për zgjerimin e varrezave në Davidovc.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota "Për", me 10 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" miratoi rendin e ditës.

#### Pika 1

##### Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 15.12.2023

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Rrahman Jakupi;** Përshëndetje, ky procesverbal nuk ja vlen me u votu sepse është i varfër në përmbajtje. Kërkoj që ky procesverbal të përmirësohet.

**z.Reshat Mujota;** Përshëndetje, edhe unë kam shqetësimet e mija për procesverbal, prandaj nuk e votoj dhe jam kundër këtij procesverbal. Ja ke hup kuptimin fjalëve në diskutimin tim, sepse nuk ka drejtori për buxhet.

**znj.Albana Podvorica;** Përshëndetje, nuk pajtohem me procesverbalin për devijimin e pyetjeve. Kërkoj që pyetjet të vendosen ashtu siq kanë ndodhë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota "Për", me 7 vota "Kundër" dhe me 3 vota "Abstenim", miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 15.01.2024.

#### Pika 2

##### Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, fjalën ja jap Kimete Ukaj.

**z.Kimete Ukaj, ZKF;** Përshëndetje, bazuar në ligj ne jemi të obliguar që Draft-Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024, ta qesim për votim në Kuvend, kjo bëhet për çdo vit, dhe para miratimit duhet të qitet në diskutim publik, draftin e keni marrë me kohë, kështu që unë ju ftoj që ta miratoni vendimin për diskutim publik.

**z.Përparim Ramusa;** Jemi për me shku në diskutim publik.

**z.Reshat Mujota;** Në rregullore duhet të ceket se lirimi te veteranët a vlenë për një person apo vlenë për familjen e ngushtë, dhe nëse po për familje atëherë për cilët anëtarë të familjes. Edhe te veteranët propozoj që të hiqet taksa prej 10 euro.

**z.Besnik Seferi;** Pajtohem që te kjo rregullore të bëhen disa ndryshime. Te KPK-ja anëtarë i të cilës jamë, kemi një Rekomandim që të shkruhet Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptas e jo (RAE).

**z.Kadri Emini;** Jemi që të shkojë në debat publik, dhe ndryshimet ipen në debat publik.

**z.Rexhep Gashi;** Te pika 8.2 Veteranët i specifikoni si të UÇK-së, se ka veteranë të ndryshëm.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Propozim-Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria Komunale për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

### Pika 3

#### Raport Vjetor Buxhetor (shpenzimet) për vitin 2023

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.

**z.Kimete Ukaj, ZKF;** E kemi obligim ligjor të prezantojmë raportin vjetor buxhetor, duke u bazuar në ligjin për menaxhimin e financave publike. Në vazhdim lexoi raportin buxhetor sipas kategorive me shifrat konkrete (shih dokumentin) materiaiin e keni marrë nëse ka pyetje do të përgjigjem, kështu që ju ftojë ta votoni.

**znj.Adelina Beqa;** Pëshëndetje, faleminderit për raportin në qeverisjen e Kryetarit Aliu që ishte 95.62, në periudhën kur është dashur më shumë me punu është shpenzuar vetëm 17%. Kjo qeverisje ka hargjuar 7 mijë euro për dreka zyrtare.

**znj.Sanie Sadiki;** Sa i përket llogaridhënies kjo qeveri ka dalë me performancën më të mirë për 100% për sa i përket transparencës. E falënderojë, Kryetarin Aliu, për punën e bërë sepse për punën e bërë dhe transparente që e ka bërë edhe e kemi fituar grandin e performancës ndër komunat më të mira.

**znj.Adelina Beqa;** Replikë, më vjen mirë që e morre fjalën, sepse projektet janë vetëm në hava e në tokë nuk ka kurgjë.

**z.Përparim Ramusa;** Kimetin e falënderojë për raportin. Po ndalem te shpenzimet e luksit ku i ka shpenzuar 36 mijë euro dhe 7 mijë euro dreka zyrtare. Ky është shpenzim i tepërt, dmth nëse i kalkulojmë del që janë hanger 2600 gullasha. Te investimet ju ka dhënë pompozitet shumë p.sh. tregu ka pasë me u përfundu dhe nuk është përfunduar, nuk është përfunduar as rruga Godanc-Gjyrkovc.

**z.Besnik Seferi;** Kur folke Përprimi mu doke vetja sikur jam në opozitë. Por realiteti është krejt ndryshe projektet nuk janë në hava siq po thuhet këtu p.sh. shikoni rrugën "Tranzit" ka përfunduar, ndërtimi i QKMF-së do të fillojë në vitin 2024, Qerdhja në Petrovë dhe në Godanc, renovimin i shumë shkollave, pastaj biblioteka do të hapet së shpejti.

**z.Përparim Ramusa;** Repikë, po diskutojmë për shifrat financiare e jo për projekte.

**z.Muhamet Ademaj;** Pëshëndetje, kur flasim për raportin mund të themi se është përgaditur mirë, i cili përmban shifra që buxheti është shpenzuar mbi 95.62% e që është një sukses shumë i mirë kështu që viti 2023 konsiderohet si vit i sukseshëm, prandaj ne si grup parlamentarë e përkrahim dhe do ta votojmë.

**z.Reshat Mujota;** Nuk deshta me folë, por po më nxisin, shqetësuese për mua është 7 mijë euro dreka zyrtare për një vitë. Të shpenzohen e të mos dihet se për qfarë janë shpenzuar, ky është shqetësimi im. Kërkojë që këto dreka të jenë sa më të vogla. Me një drekë janë mbi një mijë euro te Besimi Comerc.

**z.Hamëz Tërshani;** Pëshëndetje, e vlerësojë se qka tha Sanija por e ka gabim. Deri sa e mshefë ekspertët që punojnë për Komunën tonë. Sa janë obligimet e Komunës së Shtimes sa janë obligimet kontigjente dhe kurë priten të realizohen? Pse nuk është realizuar blerja e veturave? Sa kanë qenë pagesat për AZHR-në. Ndryshimi është se ne nuk shkojmë te Kryetari për dallim nga Besniku e Muhameti.

**z.Besnik Seferi;** Unë vetëm një herë kam hyrë në zyrën e ish Kryetarit para mbledhjes, e nëse mund ta vërtetoni se ka ndodhur më shumë herë atëherë unë jap dorëheqje nga ky Kuvend.

**z.Asllan Beqaj;** Pëshëndetje, flasim për persona e kush ka ndryshu polizikisht, e nuk e kanë kurajon të flasim për punët e mira që kanë ndodhur me këtë qeverisje. Fakt është se kur rritet besimi te qeverisja, është e logjikshme që rritet edhe pagesa e tatimeve, ky është një indikator shumë i rëndësishëm. Nuk shpenzohet buxheti 100% në tre mujorin e parë, kjo pra shkon gradualisht sipas përfundimit të punëve nga operatorët ekonomik, kështu shpenzohet buxheti. Unë vetëm po e pasqyroj realitetin i cili është paraqitur në raport. Dëshmia më e mirë për punën dhe shpenzimin efikas të buxhetit për 2023 është fakti se Komuna e Shtimes është përfituese e grandit

të performancës. Nga të hyrat janë grumbulluar 900 mijë euro dhe kjo ka ndodhur sepse është rritë besimi me mbi 150 %. Ky është trend i mirë dhe duhet me vazhdu me rritë trendin edhe më mirë.

**z.Kadri Emini;** E kemi diskutuar edhe në KPF është një raport i detajuar. Ja vlenë me i diskutuar edhe shpenzimet kapitale që janë me 92% që të bënë me u ndie mirë, e përgëzojë DPUKGJ-në për këtë angazhim. Shpenzimet në gastronomi janë rrit dhe në këtë qeverisje ka ndodhë sepse asnjëherë më parë nuk ka ndodhur që komunën tonë me e vizituar kaq shumë Ministra. Kjo ndodhë gjithkund ku ka aktivitetet, ka ndodhur edhe në Lipjan ku qeveris LDK-ja. Ne jemi "për" ashtu sikurse në KPF.

**z.Rexhep Gashi;** Faleminderit për raportin, anën profesionale nuk e dyshojë aspak. Nuk është sukses të shpenzohet 95.62 % por të shpenzohet ashtu siq duhet. Pozita thotë çdo herë raporti është i mirë e opozita të kundërtën. Ne jemi këtu gjithëmon për interesin e qytetarit. Shpenzimet marramendëse 7 mijë euro për dreka zyrtare. Nuk e arsyetojë qeverisjen e kaluar sepse edhe këta kanë shpenzuar.

**znj.Zenije Veliu;** Përshëndetje, raporti është bërë mirë, edhe realizimi po ashtu është shumë mirë me 95.62%. Kjo qeverisje ka tregu trasnaprenc e llogaridhënje. Raporti i Auditorit të pëgjithshëm është i pa kualifikuar që është kualifikimi më i mirë, pastaj ne jemi edhe përfitues të grantit të performancës. U tha që projektet janë në hava, unë ju kisha thënë, mbani kokën teposhtë i shihni projektet në tokë. Duhet të jenë më të qartë.

**z.Muhamet Ademaj;** E dëgjëva kolegën që tha se kam shku te zyra e ish Kryetarit. Ne jemi kuvendarë dhe ish Kryetarin e kam pas kolegë pune, dhe takimet kanë qenë në të mirën e qytetarëve.

**znj.Adelina Beqa;** Ta kish pas ish Kryetari një buxhet të tillë e kishit pa se qfarë pune do të ishte bërë. E sa i përket zgjatjes të diskutimit unë do të flas sa të është e nevojshme.

**z.Reshat Mujota;** Pajtojë me Muhametin që tha se shkojë te Kryetari, por mënyra e disave qysh kan hi te Kryetari është shqetësuese. Kryesues, replikat mos i lejo, kështu me bisedu njëri me tjetrin.

**z.Përparim Ramusa;** Për tema personale nuk kam dëshirë me bisedu. Te Kryetari duhet me shku por jo me ju nënshtru. Shpenzimet prej 36.500 euro për karburante mendojë se nuk është reale edhe 7 mijë euro për kafe nuk është reale. Pse huamarrja është heqë edhe pse OJQ "Katari" ka ikur nga Shumja dhe po vepron në QKMF - Ferizaj, pse këto projekte nuk janë realizuar.

**z.Kimete Ukaj, ZKF;** Tek shpenzimi i buxhetit normal që pagesat bëhen në 6 mujorin e dytë pasi të realizohen projektet nga operatorit. Janë rritë taksat nuk qëndron, sepse te rregullorja për Taksa nuk është rritë asgjë ju e dini këtë. Te lejet ndërtimore janë rritë të hyrat, është një rritje e madhe ku i kemi rritë mbi 100%. Njerëzit janë vetëdijësuar që pa pagesën e tatimit nuk bënë. Kufirin e të hyrave nuk e caktojmë ne por Ministrija e financave që i marrin tri vitet e fundit. Për drekat zyrtare jan hargjuar 7 mijë euro në të kaluarën është shpenzuar edhe më shumë. Duke marrë parasysh në të kaluarën Pandeminë. Kemi pasë edhe dreka me shoqatat e dala nga lufta, keni shpenzuar edhe ju si Kuvend, pastaj kemi pas edhe festën e QKMF-së. Nuk është shumë e madhe 7 mijë euro. Te kontrata kolektive që u cek është zyrtari Ligjor, ne kemi paguar dhe kemi me paguar ende kjo do të ndodhë sipas vendimeve të Gjykatave. Grandin e performancës e bëjnë dy faktor e para Raporti i Auditorit të pëgjithshëm i cili është ranguar si i Pakualifikuar, dhe faktori i dytë është realizimi i buxhetit te projektet kapitale i cili te ne është mbi 92 %. Mirë është me shku shpenzimi sipas planifikimit, por është gati e pa mundur te projektet kapitale.

**z.Besnik Seferi;** Faleminderit për sqarimet nga Kimeti. Në vitin 2018 te drekat zyrtare shuma e shpenzimeve ka qenë 26.000 euro brenda 6 mujorit të parë.

**z.Përparim Ramusa;** Besniku e tha një të pavërtetë sepse shpenzimet janë bërë nga Qerdhet e jo nga drejtorat.

**z.Besnik Seferi;** Pikërisht për të njejtat arsye janë bërë edhe këto shpenzime të sotit për të cilat po diskutojmë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Po u tërheki vërejtjen përsëri se duhet të përmbaheni dhe duhet me e dëgju kolegën deri ta kryen diskutimin.

**z.Rrahman Jakupi;** Për vitin 2018 ju njoftojë se për këtë shpenzim janë 45.549 euro ju i keni si shpenzime totale, e me na shitë neve kopalla këtu se ju keni shpenzuar më shumë jo jo. Projekti i

rrugës Shtime-Lipjan ende nuk ka përfunduar. 36 mijë euro kontratë, është tepër nuk ju konvenon me folë. Transparenca, farë transparence kur për një dokument nevojitet një javë për me marrë për sa i përket qasjes në dokumente zyrtare. E kam një vërejtje serioze për drejtorat që nuk duhet me na lodhë edhe mos me na folë se çka flasim. Ky buxhet ka të shkelura e do ta vërtetojë koha. Për pjesën profesionale e falenderojë Kimete Ukaj.

**znj.Sanie Sadiki;** Si mundet me folë kështu parafolsi kur pastruesja e Qerdhes ka qenë me ja pastru shtëpinë e vet për brenda.

**z.Rrahman Jakupi;** Kqyre more ti vetin kah je shku me naj minister a zëvendësministër.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** zotri Jakupi, nuk tolerohet kjo gjuhë ofenduese, ti duhet ta tërheqësh fjalën për znj.Sadiku, ku thae ke shku e nuk ke shku me ndonjë ministër a zëvendës ministër. Nuk lejoj asnjë diskutim pa ja dhënë unë fjalën, po flasë për respektimin e rregullores.

**z.Përparim Ramusa;** Kjo gjendje kaotike nuk është e mirë, nuk përmednet familja edhe kolegu u ngut për kolegen nuk është e rrugës kështu të diskutohet.

**z.Besnik Seferi;** Rrahman Jakupi duhet me pas kujdes, dhe në emër të grupit parlamentar të VV-së, kërkojmë të tërheq fjalën.

**z.Kadri Emini;** Debat ka dalë jashtë gjuhës parlamentare. Nuk duhet me përmend as vajzën e as bashkëshorten, nuk duhet me shku në personale. Kryeatrin e PDK-së e inkurajoj për me tërheqë fjalën sepse nuk është njësoj sikurse me prek njeriun në moral sikurse në këtë rast për Sanijen, me ratsin kur përmendet bashkëshortja juaj për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Pesë minuta pauzë për konsultime me përfaqësues të grupeve parlamentare në ora 11:22h.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Vazhdon mbledhja e Kuvendit në ora 11:28h, në vazhdim fjalën ja jap z.Rexhep Gashit.

**z.Rexhep Gashi;** Është për keqardhje ky debat për asambleistin, Shtimja nuk e meriton një debat të tillë. Çështja e koleges Sanie që e ngriti për bashkëshorten e kolegut në Çerdhe, mendoj që asambleistja duhet ta tërheqë fjalën. Edhe fjala e Kryetarit të PDK-së Rrahman Jakupi është gjuhë jo pralamentare dhe duhet ta tërheqë fjalën. Është mirë të na bëjnë nderë dhe është njerëzore.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Tani më besoj se gjakrat janë ftohur, dhe po kërkojë me tërheqë fjalën.

**z.Rrahman Jakupi;** Tendencat me familjen time kanë qenë nga fillimi. Egoja e tij është piknisje ndaj PDK-së. Nuk mundet askush me ma ndalë fjalën. Kjo nuk është sallë e Gjykatës. A e dini çka do të thotë fjala moral. Tërheqja e fjalës duhet me u bë aty ku ka filluar, unë nuk e tërheqja fjalën.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Kërkojë nga Sanije Sadiki ta tërheqë fjalën për vajzën, e bashkëshortja është drejtoreshë e Çerdhes dhe mund edhe të përmendet në Kuvend.

**znj.Sanie Sadiki;** Unë nuk kam çka me diskutu.

**znj.Adelina Beqa;** Si përfaqësuese e grupit jo formal të grave ndihem keq. Kërkoj nga dy anëtarët që ta tërheqin fjalën para qytetarëve. Pa marrë parasysh parti të politike.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Është krijuar një situatë e pa këndshme në Kuvend me diskutime jo parlamentare nga asambleisti që ka të bëjë direkt me moral, kjo është shkelje e rregullores të punës së Kuvendit. Unë jam: babë i një vajze dhe në emër timin personal po them se nëse nuk ka tërheqje të fjalës nga Rrahman Jakupi, unë nuk mund të qëndroj në sallë me një ofendues të tillë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Propozoj që të shkojmë në pauzë të drekës dhe nëse nuk tërheqet fjala nga asambleistët atëherë do ta ndërpresim mbledhjen.

Pauzë nga ora 11:46h.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Po vazhdojmë me mbledhjen në ora 13:20h Edhe njëherë kërkojë nga Rrahmani e Sanija të tërheqin fjalët e tyre sepse ishin fjalë as njerëzore e as humane. U dakortuan edhe shefat e grupeve që të bëhet një gjë e tillë.

**znj.Sanie Sadiki;** Për hirë të opinionit publik unë po sqaroj se kam folë për ish nënkryetarin, kryetar i një partie politike e tani asambleist. Për pjesën që vajza është përfshi në debat, unë e tërheqja fjalën, ndërsa bashkëshortja është pjesë e institucioneve lokale.

**z.Rrahman Jakupi;** Qytetarë nuk ekziston më inçizimi, unë do të ngris kallëzim penal për këtë. Tash unë kërkoj nga ti që ta kem inçizimin. Unë kam thënë ndoshta, edhe ti çka ke thënë është e njejta. Unë tërhiqem nga fjala me vërejtjen që unë kam thënë ndoshta, edhe Kryetarin po e përfshi

në këtë sepse komunikon me SMS. Keni kujdes kur të ja gjuni dikujt shpijen sepse e juaja është në xham. Keni kujdes.

**Kryesuesi, z. Adnan Ademi;** Në fjalimet ku përfshihen anëtarët e familjes kjo nuk na qon askund. Faleminderit që i tërhoqët fjalët. Tani po vazhdojmë me pikën e rendit të ditës, edhe KPF por edhe KPK-ja i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e kësaj pike.

**znj. Sanie Sadiki;** Unë nuk dëgjova kërkim falje nga Kryetari i PDK-së le të mbetë në ndërgjegjën e tij, por unë do të përgaitem të bëjë padi për shpifje, që ka thënë se unë e kam savatuar shtëpinë me pare të Komunës.

**Kryetari, z. Qemajl Aliu;** Përsëritetja e pamë një situatë jo të këndshme. Pika e e tretë u kalua pa u diskutua konkretisht për këtë pikë por duke u marrë me akuza e fjalë joparlamentare. 96% e buxhetit është realizu. Jemi në mesin e 5 Komunave më të mira që e kemi fitu grandin e performancës, poashtu edhe raporti i Auditorit të përgjithshëm që është i pa kualifikuar, kjo tregon qeverisje të mirë dhe të dinjitetshme. Te shpenzimet kemi pikat e forta dhe të dobëta. Pika e fortë është kursimi i buxhetit. U përmenden 7.200 euro, këto shpenzime janë komplet të arsyeshme, kemi pritë delegacione të ndryshme edhe nga Gjermania, kemi pas promovim të librave, kemi pas ditë të UÇK-së. Në vitin 2018 janë hargjuar për dreka zyrtare 22,900 euro që do të thotë tri herë më shumë pastaj ka pas edhe për pije dhe bashkë bëjnë mbi 60.000 mijë euro. Për karburante atëher janë hargjuar 3 herë më shumë se sa sot edhe pse nafti atëher ka qenë 1 euro e sot është 1.30-1.60 euro. Për 3 vite në qeverisje unë si Kryetar i Komunës së Shtimes deklarohet se asnjëherë kurrë nuk kam marrë asnjë mëditje. E di që ju jeni këtu për me bërë akuza, por është krejtësisht e kotë sepse kjo është pika më e fortë e imja. U tha projekte në hava, duhet thënë hapur se këtu pra ka një diskrepancë të madhe sepse në të gjitha mediumet është përmend se Shtimes po i ndahen shumë projekte, e ju po thuani projekte në hava, cilit tash duhet me i besu. Sa i përket huamarrjes (OSTAP) ka me u bërë një analizë për gjendjen e projektit, dhe duhet të shikojmë mundësinë për ta vazhduar këtë projekt të rëndësishëm. Sa i përket projektit me OJQ - "Katari", është ligji për financat publike që nuk po na lejon bashkimin e mjeteve finciare me një OJQ. Kemi bërë kërkesë për interpretim ligjor. Ministria ka thënë se nuk lejohet. Kolegët pse mund ti shkelin ligjet unë nuk i shkel.

**z. Përparim Ramusa;** Në emër të grupit parlamentar, por kjo nuk do të thotë që të tjerët nuk mund të flasin, a je ti Kryetar që e paguan drejtorin prej Kaqanikut dhe Fushë Kosovës. Në po akuzojmë për shpenzime e jo për kursime. I keni shpenzu paret pa nevojë. Ke paguar ekspertë, qiti emrat sa pare i ke paguar?

**z. Besnik Seferi;** Është stërgjatë, ne propozojmë që kjo pikë të qitet në votim.

**z. Kadri Emiri;** Në fillim unë e dhashë mendimin e grupit tonë LDK-AKR ne jemi që të kalojmë.

**z. Rexhep Gashi;** Sqarimet e Kryetarit nuk janë të sakta kur thu nuk ka shkelje, Auditori ka gjetur disa shkelje të përsëritura. Ne ju kemi votuar dhe ju kemi besuar se nuk i përsëritni ata.

**Kryesuesi, z. Adnan Ademi;** Kontatoj Kuorimin pre 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota "Për", me 8 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim", miratoi Raportin Vjetor Buxhetor (shpenzimet) për vitin 2023.

#### Pika 4

#### Draft-Rregullore për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes (Pas diskutimit Publik)

**Kryesuesi, z. Adnan Ademi;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bardhyl Rushiti.

**z. Bardhyl Rushiti, DSHP;** Përsëritetja sipas vendimit të Kuvendit kemi organizuar diskutim publik për të cilin i kemi marrë me shkrim propozimet e bëra (shih dokumentin). Në vazhdim i lexoi të gjitha kërkesat. Keni kërkuar edhe peticionin ky është mund ta merrni nëse doni.

**z. Kadri Emiri;** Faleminderit për prezantimin e draft-rregullores po diskutoj për gjatësinë e orarit. Propozoj të ndryshohet te Gastronomia, te lokalet në katin e dytë te objektet e banimit kolektiv, mos me leju me punu pas orës 10:00h dimrit, dhe pas orës 11:00h verës. Familja është e shejtë, propozoj të bëhet një ndarje e tillë.

**z. Bardhyl Rushiti, DSHP;** E kuptoj këtë, por nëse bëhet me selektim është shumë e vështirë me e zbatua. Përveç rregullores e kemi edhe ligjin që i ndalon veprimtaritë që krijojnë zhurmë.

- z.Kadri Emini;** Atëherë a është e mundur me ndalu komplet verpimtarinë në ora 10:00h.
- z.Reshat Mujota;** Unë e mbështes propozimin e Kadriut. Por më mirë është me i sjellë procesverbalet. Çka ka pas të keqe me punu me orarin deri në ora 23:00h. Duhet me llogaritë edhe orarin e punës të punëtorit aty. E dyta është jo reale dhe te pika 3 nuk guxon me pas këtë pikë kështu; duhet të vendoset në Kuvend e jo aty të thuhet organet kompetente duhet të ceket kush ndryshe e nuk e përkrahu.
- z.Bardhyl Rushiti, DSHP;** Sa i përket punëtorëve e mbikëqyrin Inspektorati sipas ligjit. Orarin kështu e kanë kërkuar bizneset.
- znj.Adelina Beqa;** Në KPF kam votuar me një rekomandim, e që dretjori nuk e ka pru rekomandimin. Nëse nuk mundesh me ndalë deri në ora 23:00h atëherë me ndalë zhurmën. Po pajtohem me pjesën e ligjit, prandaj edhe kam kërkuar një rekomandim të drejtorit.
- z.Bardhyl Rushiti, DSHP;** E falenderoj grupin punues dhe ne e kemi sjellë në Kuvend materialin.
- z.Hamëz Tërshani;** Sa është numri i bizneseve dhe sa është e rrezikshme që paret e Komunës së Shtimes të shkojnë në Komuna tjera?
- z.Bardhyl Rushiti, DSHP;** Këtu i kam 23 nënshkrime të bizneseve. Orarin e punës e mbronë ligji i punës.
- z.Besnik Seferi;** Po i gëzohem kësaj rregullore, duhet me u gëzuar sepse kjo ka të bëjë me të drejtat e punëtorëve dhe bizneseve. Dita e dielë ka qenë ditë pune për të gjithë, prandaj është e mirë kjo rregullore për të gjithë. Porpozoj ta votojmë.
- z.Përparim Ramusa;** Unë jam në anën e punëtorve, është shumë jo serioze me ardhë këtu pa rekomandim. Sa janë të mjaftueshme 2 markete kujdestare në Shtime. Kjo nuk është rregullore profesionale, por nëse inkorporohet kërkesa e Nderimit unë do ta votojë.
- z.Asllan Beqa;** E para, unë kam lexuar rregullore të tjera që janë shumë të njehta. Rregulloren e implementon policia dhe inspektorati, si dhe ligjin për punën. Pajtohem me propozimin e Kadriut.
- z.Kastriot Shabani, DZHE;** Përshëndetje në rregullore është potencu vetëm në Shtime, unë jamë që te objektet banesore të veprohet sipas propozimit të Kadriut.
- z.Rexhep Gashi;** Sa u janë përgjigjur bizneset te dëgjimi publik, arsyeja që nuk kanë marrë pjesë në dëgjimin publik është mosnjohimi. Te neni 3 nëse thuhet se i ka kompetencat Ekzekutivi atëher pse duhet të vie në Kuvend. Mendoj që kjo duhet të hiqet.
- z.Lumni Amrushi;** Këtë pjesën e fshatrave a bënë me sqaru edhe njëherë, te pishinat p.sh. nuk është në rregull që rregullorja të vlejë vetëm në qytet. Unë nuk e kam realizuar mirë këtë rregullore.
- z.Bardhyl Rushiti, DSHP;** Rregullorja është për krejt Shtimen, por bizneset janë të koncentruara në Shtime.
- z.Reshat Mujota;** Te pika 3 kërkoj të hiqet ose të silllet prap në Kuvend. Te neni 8 le të mbetet deri te ora 23:00h. Duhet me pas kujdes te lokalet e lojrave që po i japin mundësin fëmijëve me nejt deri në ora 24:00h. Dmth. le të mbetet 08:00 deri 23:00h edhe verës edhe dimrit.
- z.Muhamet Ademaj;** E falenderoj drejtorin për këtë rregullore, kërkojmë zbatimin e saj. Pashë 30 nënshkrime a janë ato biznese familjare?
- z.Rrahman Jakupi;** E kemi një kërkesë të Nderim Hysaj i cili ka kërkuar orarin 8-22 dimrit dhe 8-23 verës, kërkoj që të hudhet në votim.
- znj.Adelina Beqa;** Mirë që na ka ardhur si rregullore, i kemi 30 nënshkrime dhe këtu janë 30 familje. Qite në votim.
- z.Kadri Emini;** Unë e pata idenë ndryshe, tani sa i përket gastronomisë unë jam që në ora 22:00h të ndalohet muzika. Dhe në raste të veqanta të merret leje e posaqme.
- z.Bardhyl Rushiti, DSHP;** Rregullorja vlenë për krejt territorin e Komunës së Shtimes.
- z.Reshat Mujota;** I pata disa propozime te video-lojrat. Rregulloret i bjen Kuvendi. E unë i kam propozimet e mija, e para të hiqet pika 3 dhe te video-lojrat të mbetet orari deri në ora 22:00h.
- z.Bardhyl Rushiti, DSHP;** Është më e arsyeshme që me vendosë drejtoria sepse kërkesat janë të tilla që ndoshta duhet me vendos brenda ditës.
- z.Rexhep Gashi;** Te neni 8 a janë kah e ndryshojnë këtë pikë, ne e dham deri në ora 22:00h. Të sqarohet ardhja e bashkatdhetarëve si dhe të mbjellurat, le të sqarohen.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; I kemi të gjitha kërkesat e bizneseve që janë futë në draft dhe propozimin e Kadriut për zhurmën që të ndalohet në ora 22:00h. Në vazhdim Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 16 vota "Për", me 0 vota "Kundër" dhe me 5 vota "Abstenim", miratoi Draft-Rregulloren për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes (Pas diskutimit Publik), me konstatimet e Kryesuesit.

#### Pika 5

##### Draft-Rregullore Komunale për Transparencë. (për diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Propozim-Rregulloren Komunale për Transparencë.

#### Pika 6

##### Draft-Plani i veprimit për transparencë komunale 2024-2028. (për diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Planin e veprimit për transparencë komunale për periudhën 2024-2028.

#### Pika 7

##### Raport i Punës së Kuvendit për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Prezantoi raportin e punës së Kuvendit për vitin 2023, janë mabjtur 10 mbledhje të rreguilta, 5 mbledhje të jashtëzakonshme, 1 mbledhje urgjente, 4 mbledhje solemne dhe 1 mbledhje përkujtimore. Në vazhdim lexoi të dhënat nga raporti (shih dokumentin).

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për raportin, unë dëshiroj që ta realizojmë planin e punës.

znj.Adelina Beqaj; Me gjithë sfidat që kemi pas prap kemi një rezultat. Mirë është që të raportohet edhe për punën e anëtarëve të Kuvendit. Me 15 Janar të mbahet një mbledhje solemne për Reçakun.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për Reçakun është mbledhje përkujtimore e jo solemne, por duhet me ditë se agjenda është e Qeverisë nën patronatin që e ka. Për sa i përket raportit të anëtarëve të Kuvendit mi sillni ju raportet e punës në fund të vitit, unë do ti prezantoj.

znj.Adelina Beqa; Po e di që është mbledhje përkujtimore. Për raportet sigurisht që në fund të vitit do ti sjellim.

z.Rexhep Gashi; Vendimi për fshatin Pjetershicë a është kthyer nga MAPL-ja?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Të gjitha mund ti merrni te Sekretaria.

z.Reshat Mujota; Raportimet nuk po përputhen me numrat që ka të bëj me raportet e Kryetarit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 17 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 10 vota "Për", me 0 vota "Kundër" dhe me 7 vota "Abstenim", miratoi Raportin e Punës së Kuvendit për vitin 2023.

#### Pika 8

##### Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për ndarjen e titujve të nderit

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Qelsi është propozuar që të jetë përbërja e Komisionit prej 2 anëtarëve nga Kuvendi, 2 anëtarë nga Ekzekutivi, dhe një anëtarë nga OJQ-të.

z.Përparim Ramusa; Ne jemi "për" dhe po dëshiroj që këtu në këtë pikë të jemi bashkë. Ne si opozitë e caktojmë emrin edhe pozita përfaqësuesin e vetë, Kryetari i bjen emrat e tjerë dhe ne do ta votojmë.

z.Reshat Mujota; Edhe unë pajtoj me qelsin prej 5 anëtarëve. Por pse Kuvendi nuk e kryen punën e vetë edhe me i zgjedhë menjëherë anëtarët e vetë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 19 vota "Për", me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim", miratoi Vendimin për zgjedhjen e Komisionit për ndarjen e titujve të nderit, sipas Qelësit 2+2+1.

#### Pika 9

##### Draft- Programi Strategjik për ujërat në Komunën e Shtimes. (pas diskutimit publik)

**Kryesuesi, z. Adnan Ademi;** Fjalën ja dha Nënkrjetarit z. Faruk Beqa.

**z. Faruk Beqa, Nënkrjetar;** Përshëndetje, ne kemi një memorandum mirkuptimi me organizatën "GIZI" që ka yë bëjë me programin strategjik për ujëra në Komunën tonë. Është formuar grupi punues ku kemi hartuar një draft-program për ujërat injaftë përmbajtësor. E kemi mbajtur edhe dëgjimin publik sipas vendimit të Kuvendit ku janë inkorporuar propozimet që kanë dalë nga tubim. Ne e falenderojm z. Muhamet Qeriqi që ka dhënë një kontribut mjaftë të mirë. Ju ftojë që këtë program startegjik ta miratoni meqenëse se është në të mirën e qytetarëve së Komunës së Shtimes. Nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

**znj. Adelina Beqa;** Në njëërën nga dëgjimet publike kam marrë pjesë edhe unë. Desha të lidhem pak te kolektori puna e të cilit është ndërpre. Çka parashihni me bërë me ujërat e zeza?

**z. Faruk Beqa, Nënkrjetar;** Plani i ujërave të zeza nuk është ndërpre, ai do të vazhdojë me KRU "Pristina". Realisht është ndërpre vetëm financimi, ose më mirë me thënë burimi i financimit por jo edhe vazhdimësia e projektit.

**znj. Adelina Beqa;** Për këtë arsye unë pyeta se si mund ta votojmë këtë dökument kur është ndërpre kolektori. Nuk më keni ftuar në punën e grupit punues.

**z. Faruk Beqa, Nënkrjetar;** Unë nuk kam qenë bartës i asnjë funksioni në këtë Komision, por e di që nuk ka pas asnjë tenativ për ta penguar punën e tij. Unë ju falenderoj të gjithve që keni marrë pjese dhe që keni kontribuar në këtë program

**z. Reshat Mujota;** Te çështja e lumenjeve dhe deponive ilegale sa keni mundur me i indentifikuar këto për këtë plan. Sa burime të uji janë si është gjendja e tyre? Në Llanisht ka gurthyes a i keni paraparë gjithë këto sfida? Mollópolci 90% e kanë ujin prej bjeshkëve. Lumenjtë mund të shterohen por për këta banorë çka do të bëhet.

**z. Faruk Beqa, Nënkrjetar;** Programi është mjaftë i gjerë, po duhet me shkurtu në projekte konkrete. Jemi dëshmitar që po ballafaqohemi me ujëra të ndotura. Kemi qenë në teren dhe kemi indentifikuar përveç ujërave edhe për deponit e mbeturinave inerte.

**z. Muhamet Adema;** Falemindrit për këtë draft e vlersojmë këtë punë të grupit. Kam shqetësimet për mbrojtjen e 3 lumenjeve që i kemi. Kërkoj të fillojë të rregullohet kolektori në fshatin Gjyrvoc. Është mirë që ti ruajmë burimet e ujit.

**Kryesuesi, z. Adnan Ademi;** Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Draft- Programin Strategjik për ujërat në Komunën e Shtimes, (pas diskutimit publik).

#### Pika 10

Propozim-Vendim për ndarjen e subvencionev. për nënat Lehona për fëmijët e lindur në vitin 2024  
**Kryesuesi, z. Adnan Ademi;** Në KPF jemi dakorduar që në Kuvend të na sjellin shifrat konkrete për këtë vendim.

**Kryetari, z. Qemajl Aliu;** Për këtë vendim ne propozojmë, siç e dimë kemi filluar që nga viti 2022. Sivjet e kemi bërë një analizë. Fëmija i parë 100 euro, fëmija i dytë 150 euro, fëmija i tretë 200 euro, për binjakët 500 euro, për trinjakët 1000 euro, për çdo njak tjetër nga 500 euro shtesë. Këto janë mundësitë buxhetore.

**z. Besnik Seferi;** Unë do ta ngris doreën me kënaqësi, kemi diskutuar për këto mundësi dhe e kam përkrahur.

**z. Përparim Ramusa;** Falemindrit për propozimin do ta përkrahim. Për drejtorin e shëndetësis pse po e mbanë mshuft.

**znj. Rrezartë Ramadani;** Falemindrit edhe ne do ta përkrahim vendimin si grup parlamentar.

**z. Lumni Amrushi;** Edhe ne e përkrahim është një mundësi e mireë për fëmijët. Kam propozim që fëmija i parë me të dytin të jenë njëjtë.



znj. Adelina Beqa; Unë e përkrahi propozimin, unë ju inkurajoj që të vazhdoni dhe jam pro. Urime për gratë e Komunës tonë.

z. Rexhep Gashi; A është aneksi i rregullores së mëparshme a është vendim i ri?

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 19 vota "Për", me 0 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim", miratoi Vendimin për subvencionimin e veçantë për secilën Nënë-Lehonë, për çdo fëmijë të lindur gjatë vitit 2024, si dhe për fëmijët e lindur në vitin 2023 e të cilët nuk kanë pas mundësinë të aplikojnë për realizimin e të drejtës së tyre, gjatë vitit 2023, si vijon:

1. Fëmija i I-rë do të subvencionohet me 100 €;
2. Fëmija i II-të do të subvencionohet me 150 €;
3. Fëmija i III-të e tutje do të subvencionohen me nga 200 €;
4. Fëmijët binjakë do të subvencionohen me 500 €;
5. Fëmijët trinjakë do të subvencionohen me 1000 €;
6. Shumës prej 1000 € ( për trinjakë ) do t'i shtohen edhe nga 500 € për çdo fëmijë të lindur njëkohësisht më shumë se trinjakë.

Pika 11

Propozim-Vendim për Inicimin e procedurës të themelimit të Ndërmarrjes Publike Lokale për kryerjen e shërbimeve publike në Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Ne kemi pasë një kërkesë nga Adelina për me gjetë vendimin e mëparshëm për Kryetarin që ka të bëjë me ndërmarrjen KRM "Pastërtia".

znj. Adelina Beqa; E kemi një vendim të datës 30.12.2014 i nënshkruar nga Kryesuesi i atëhershëm.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Lexoi vendimin e Kuvendit Npi-01/76 të datës 27.03.2025.

z. Përparim Ramusa; Jo jo e kemi vendimin e Kuvendit të vitit 2014 që e lexoi edhe Adelina.

z. Reshat Mujota; Për mua është shqetësuse që po e hapim një kompani pa e ditur se çka po votojmë.

Kryetari, z. Qemajl Aliu; Kjo është vetëm një vendim me të cilin inicohet procedura për themelimin e një kompanie të tillë. Kjo ka me shku sigurisht nëpër shumë filtra, dhe mund të ju them se tani për tani jemi te shkronja A, dhe e kemi parasysh faktin që duhet me mbërri te shkronja ZH. Prandaj unë ju kërkojë mirkuptim që ta aprovoni këtë vendim sa për të lejuar fillimin e procedurave të mëturjeshme për themelimin e një ndërmarrje publike komunale

z. Përparim Ramusa; Kryetari ra në kundërshtim me fjalët e veta, (lexoi një dokument).

z. Reshat Mujota; E para a keni shpresë që ky vendim do të shkojë deri në fund. Dhe e dyta unë mendoj se po e rrezikojmë kompanin KRM "Pastërtia".

z. Asllan Beqa; Unë i dëgjova të gjithë me vëmendje për këtë pikë. Kjo ka të bëjë me mbrojtjen e hapsirave publike, e që po kemi gjithmonë vërejtje për punën e kompanisë "Pastërtia" për sa i përket mirmbajtjes të hapsirave publike prandaj unë mendoj se kjo është e mirëseardhur dhe duhet ta votojmë

z. Besnik Sefëri; Po flasë në emrin tim arsye ka të shumta për themelimin e kompanis publike komunale. Nuk ka të bëjë kjo me KRM "Pastërtia" sepse ajo i ka detyrat dhe punët e veta që është grumbullimi i mbeturinave. Me themelimin e kësaj kompanie kjo do ta ketë shumë më të lehtë në kryerjen e punëve.

z. Rexhep Gashi; Nuk ka bazë të mirë ligjore propozim-vendimi secili prej neve jemi pr shërbime më të mira, prandaj nuk duhet të bëjmë demagogji.

z. Muhamet Ademaj; Unë mendoj se është mirë të thememlohet një kompani e tillë e cila është në shërbim të qytetarëve, prandaj ne do ta votojmë.

Kryetari, z. Qemajl Aliu; Nuk ka lidhje kjo me kompanin "Pastërtia", ky është një vendim për inicimin e procedurës për një kompani të vogël komunale.

z. Rexhep Gashi; Ajo kompani është për qytetarët.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Kuvendi Komunës, me 11 vota "Për", me 7 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim", miratoi Vendimin për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtëmës Npi-01/364 të datës 30.12.2014.

\*Kuvendi Komunës, me 11 vota "Për", me 6 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim", miratoi Vendimin për iniciimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale në Komunën e Shtëmës.

#### Fika 12

##### Raport i Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Fjalër: ja dhe Nënkrjetarit z. Faruk Beqa.

z. Faruk Beqa, Nënkrjetar; Raportin e KKS-së në e kemi përgaditur me shkrim dhe u a kemi dërguar me kohë unë po bësoj që e keni lexuar prandaj unë nuk do të ju marrë kohë të të lexuar poe vetëm nëse ka pyetje ose komentë unë do të ju përgjigjem (shih dokumentin).

z. Muhamet Ademaj; Faleminderit për raportin, është një raport i mirë që e bënë prëshkrimin e punëve që janë kryer gjatë vitit 2023 unë do ta votojë këtë raport.

z. Rexhep Gashi; Organet e siguris po e bëjnë një punë të mirë. Unë kam një shqetësim lidhur me një tubacion i ujësjeilit që është me material nga azbesti, Siç e dini azbesti është i ndaluar që moti për përdorim prandaj duhet urgjentisht të merrni masat për largimin e këtij tubacioni.

z. Faruk Beqa, Nënkrjetar; Përgjegjësi i ujësjeilit KRU "Prishtina" imbi bazën e analizave të rregullta thotë se uji është në nivelin normal të parametrave dhe është i pijshëm. Mendoj se nuk duhet me shpërnda informata tjerë në krahasim me ato që i japin njerzit kompetent.

z. Besnik Seferi; A janë duke u përfshi të gjitha shkollat për sa i përket furnizimit me kamera dhe çështja tjetër është rreziku nga qenët endacak sidomos për fëmijët që shkojnë në shkolla në mëngjes.

z. Faruk Beqa, Nënkrjetar; Dha sqarime.

znj. Albana Podvorica; Faleminderit për raportin po ashtu e falenderoj edhe policinë për punën që po e bëjnë, dukuri negative ka mjaftë, mirpo pyetja është cilat kanë qenë masat parandaluese për ti zgjidhur këto sfida.

z. Faruk Beqa, Nënkrjetar; Ne kemi pas disa trainime duke përfshir stafin edhe nxënës, janë përfshi dikun rreth 1200 nxënës në këto trainime. Është e vërtetë se kamionat po paraqesin një problem të shkollave fillore "Emin Duraku". Policia kanë intervenuar disa herë dhe ka pasur sukses. Po ashtu edhe DSHP ka intervenu në disa raste dhe janë eliminuar disa përgjegjësi.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës së Shtëmës, unanimitisht miratoi, Raportin vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në Komunën e Shtëmës për vitin 2023.

#### Fika 13

##### Pyetje-Përgjigje

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Reshat Mujota; Pyetje për Kryesuesin, Pse nuk kanë kthyer përgjigje në pyetjet e mija, drejtorat që e kanë pas për detyrë?

znj. Albana Podvorica; Pyetje për DKA, A keni bërë ndonjë hulumtim rreth sigurisë në Shkollat, a janë të sigurtë nxënësit? Pyetje për DSHP, A ka përfunduar ndriçimi publik në rrugën Bushati në fshatin Gjyrcovc? Pyetje për DPUKQJ, Te rruga "Tranzit" a do të ndërtohet trotuari që është te Avaksi? Pse ende nuk është bërë zgjidhje për banorët e fshatit Davidovc për Parkun e Davidovcit sepse vazhdimisht po ka vërsnime? A parashihet asfaltimit i rrugës "Afrim Sylja"? Pse nuk është asfaltuar rruga "Minatori" në Góðaric?

z. Rrahman Jakupi; Pyetje për Kryetarin, Këtë pyetje e kam parashtruar edhe një herë, dyshojmë se drejtori i Shëndetësisë ka qenë pjesëtarë i MUP-it, tregona se ku ka qenë gjatë luftës ky drejtor? Neni 39 i LVL-së na jep mundësi për me kërkuar informata nga Kryetari. Pse janë vazhduar kontratat me Caritasin dhe po merrni njerëz duke u bazuar në familjarë? Dhe pse nuk jeni përgjigjur në pyetje që ju kam bërë që disa muaj?

- z.Rexhep Gashi;** Pyetje për Ekzekutivin, dhe Kryesusin, Pse Ekzekutivi nuk po bëhet më serioz për të na kthyer përgjigjet? Asamblesistët i kemi bërë 23 pyetje e në 16 prej tyre nuk kemi marrë përgjigje. Pyetje për Kryetarin, Çka është puna me ujësjellisin?
- z.Përparim Ramusa;** Pyetje nuk kam por, nuk është e tike me majtë ders në cilësinë e lnamit.
- z.Asllan Beqa;** Debatet ofenduese nuk i bëjnë mirë Kuvendit. Një sygjërim për sekretarinë, dërgonaj me E-mail.
- z.Gëzim Haxhiu;** Përshëndetje, është mirë me ju kthy rolit për çka jemi këtu. Pyetje për DPUKGI, A parashihet rre u asfaltuar segmenti i rrugës "Dëshmorët e Godancit" në Godanc?
- z.Beshik Seferi;** Pyetje për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, Çka po ndodhë për tatimin në pronë, a po falet apo jo, siç e keni premtuar dhe pse nuk ka ndodhë ende?
- Pyetje për DSHP, Parku në Gjyrvoc është demoiu, a do të ndërmeret diçka për mirëmbajtjen e këtij parku apo jo? Dhe po ashtu në hyrje të fshatit Gjyrvoc dhe në rrugën "Besnik Sopa" është bërë shkygja e dritave, apo siç themi ne prishja e tyre, a do të ketë intervenim në këto rrugë dhe të realizohet ndriçimi? Pyetje për DPUKGI, A do të bëhet këtë vit një zgjidhje për "Handikos" për një vendë-punim apo vendë për aktivitete? A u bë pranimi teknik i parkut të Shtimes?
- z.Muhamet Ademaj;** Pyetje për DSHP, Pse nuk po lëshohet ndriçimi në "Lagjen Ademaj" në Petrovë? Pyetje për DPP, Kërkojë listën e operatorëve ekonomik që kanë punuar gjatë vitit 2023?
- z.Rexhep Gashi;** Pyetje për DPUKGI; Po ta përsëris pyetjen, që ta kamë bërë më herët, qfarë ka ndodhur me kubëzat në rrugën "Tahir Sinani"? Pyetje për DSHMS, Çfarë po ndodhë me QMF-në në Muzeqinë, kur nuk kanë staf teknik?

## Pika 14

Informatë nga Drejtorja për Administratë për vitin 2023

- Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha Valon Januzi.
- z.Valon Januzi, drejtor i Administratës;** Përshëndetje, Informatën ne e kemi përgatitur në formë të shkruar dhe e kemi dërguar bashk me materialin e Kuvendit, unë po besoj që e keni lexuar. Në vazhdim lexoi informatën (shih dokumentin). Nëse ka ndonjë pyetje, unë do të përgjigjem.
- z.Përparim Ramusa;** Faleminderit për informatën, kur e pashë CV-në tane këtu të shkruar thash mos po dojnë me të kandiduar për Kryetarë. I kam dy vërejtje, sepse nuk ke arritë me i ble dy vetura, dhe vërejtja e dytë është se nuk po funksionon aparati (e-kioska) për nxjerrjen e dokumentave, pse nuk i ke kryer këto dy punë?
- z.Valon Januzi, drejtor i Administratës;** Sa i përket E-kioskës, Operatori për mirëmbajtje nuk ka mujt me shti në funksion, dhe e kemi shkëputur kontratën në vlerë prej 6000€. Mirëpo te platforma E-Kosova ka mundësi me e shfrytëzuar dhe në njëfar forme me e kompensuar. Te veturat 70.000€ nuk kanë qenë të mjaftueshme për me i ble 3 vetura. Unë i kam kërkuar edhe 10.000€ mirëpo ju si Kuvend nuk i keni miratuar. Mjetet e veturave janë nga të hyrat vetanake dhe ato i kthehen Komunës.
- z.Reshat Mujota;** Faleminderit për informatën, ke folë për dy vizita që i ke bërë në Gjermani, çka kemi përfutuar ne si komunë konkretisht nga këto vizita? Pyetja e dytë është, cili ka qenë kontributi yt në fushatën e futbollit që e ke përmend në informatë dmth. roli yt te fusha e sportit cili ka qenë?
- z.Valon Januzi, drejtor i Administratës;** Nga pozita zyrtare vizita në Gjermani nënkupton një bashkupim, ku komuna jonë përfiton një Kamion për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave, po ashtu edhe një Kamion për Zjarfiksa. Ndërkaq sa i përket sportit kjo ka qenë vetëm në nivel bashkupimi.
- z.Muhamet Ademaj;** Mendoj se kjo informatë është e qartë, administrata po bën një punë të mirë, unë kam një pyetje, se kur pritet që të fillojë rëxhistrimi i popullsisë?
- z.Valon Januzi, drejtor i Administratës;** Rëxhistrimi pritet të fillojë në muajin Prill ose në Maj, në fakt fillimisht kemi disa faza fillestare ku nga niveli qendror do të na njoftojnë për realizimin e disa aktiviteteve, mirëpo disa obligime të më hershme i kemi përmëshur.
- z.Hamëz Tërshani;** Faleminderit për informatën, si drejtor kemi bërë raporte. Para dy vjetësh është diskutuar për veturat, i kemi kalkuluar për me i marrë me qira, tash unë po kërkoj një sqarim

prej teje. Duhet me pranuar qe Komuna ka deshtuarne funksionalizimin e E-kioskës e ne e kana ble 12.000€.


**znj.Albana Podvorica;** Unë kam vërejtje te zyra e informimit, qe te mos behet diskriminim sa i perket publikimit te informatave.

**z.Asllan Beqa;** Faleminderit per informatën, per sa i perket vizites ne gjermani po shihet qe nuk kanë shkuar atje per shetitje por per pune zyrtare, e me vjen mire qe paska edhe donacione konkrete qe u ndihmon ne pune edhe kompanise "Pasqertia" por edhe Zjarrfiksave, ce eshte ne te mirën e qytetarëve. Desha ta pyes Hamzën se a keni bere ju perpara kerkesa per blerje te veturave?


**z.Hamëz Tërshani;** Jo ne kemi bere kerkese vetem per marrje me qira te veturave.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Pasi qe diskutime tjera nuk kishe Kryesuesi mbledhjen e perfundoi ne ora 18:18h

Procesmbajtësi  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi





REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA SHTIME  
 OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Buxhet dhe Financa  
 Direktorat za Budžet i Finansije

Data/Datim/Date:	21.02.2024
Nr./Br./No	11/34
Për/Za/To:	Komitetin për Politikë dhe Financa- Kuvendit Komunal Shtime
Përmes/Preko/Through:	Qemajl Aliu- Kryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Besnik Ahmeti- Drejtor i Financave Komuna Shtime Kimete Ukaj, Zyrtar Kryesor Financiar
Lënda/Predmet/Subject :	Draft –Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha per vitin 2024

I/e nderuar,

Bazuar në nenin 12.2 pika (c) dhe 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 date 03.09.2008; Si dhe në bazë të Kërkesës të Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe teknologji Nr.06-1810 të datës 24.03.2023 për Rishqyrtimin e Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha.Zyra e Kryetarit propozon Darft –Rregulloren për Taksa,Tarifa dhe gjoha per vitin 2024.

Të bashkangjitur gjeni dokumentin Darft –Rregulloren per Taksa,Tarifa dhe gjoha per vitin 2024.



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**



---

**Drejtoria për Buxhet dhe Financa**  
**Direktorat za Budžet i Finansije**

**DRAFT - RREGULLORE**

**PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA**

**2024**

Bazuar në nenin 12.2 pika (c) dhe 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimit të Aktëve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 date 03.09.2008; Si dhe në bazë të Kërkesës të Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe teknologji Nr.06-1810 të datës 24.03.2023 për Rishqyrtimin e Rregullore Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba

## **RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA**

### **I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **QËLLIMI**

##### **Neni 1**

Me këtë rregullore caktohet lartësia e Taksave, Tarifave dhe Gjobave të parapara me këtë Rregullore, që janë aprovuar në Kuvendin e Komunës së Shtimes, që do t'i paguajnë personat Fizikë ose Juridikë në emër të shërbimeve të kryera, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve apo sipas detyrës zyrtare, lejeve të punës për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe tregtare, lejeve për punë profesionale, për pronësi të automjeteve, të përdorimit apo shfrytëzimit të pronës Komunale, ngarkesave për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve, për shfrytëzimin e burimeve natyrore, gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve Komunale.

### **II LARTËSIA E TAKSAVE**

##### **Neni 2**

Mbi bazën e Ligjeve pozitive të Republikës së Kosovës, Statutit të Komunës së Shtimes si dhe kësaj Rregullore Komunale për Taksa, Tarifa, dhe Gjoba, personat fizikë ose juridikë në emër të shërbimeve të kryera Komunale do të paguajnë Tarifat si vijon:

### **DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHËSHME**

#### **Spektori i Përgjithshëm**

##### **Neni 3**

#### **3.1 Lëshimi i Certifikatave zyrtare:**

Lloji i dokumentit	Shuma €
3.1.1 Certifikata e lindjes.....	1.00 €
3.1.2 Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile.....	1.00 €
3.1.3 Certifikata e vdekjes.....	1.00 €
3.1.4 Certifikatë e martesës.....	1.00 €
3.1.5 Certifikatë e gjendjes martesore.....	2.00 €
3.1.6 Vërtetim nga Arkivi .....	1.00 €
3.1.7 Procesverbal për pranimin e atësisë dhe amësisë.....	1.00 €
3.1.8 Certifikatë e Shtetësisë .....	1.00 €
3.1.9 Certifikatë e vendbanimit.....	1.00 €

3.1.10 Dëshmi e vdekjes.....	3.00 €
3.1.11 Vërtetime të ndryshme .....	1.00 €
3.1.12 Deklaratë e bashkësisë familjare .....	2.00 €
3.1.13 Regjistrimet e mëvonshme të lindjes me certifikatë .....	5.00 €
3.1.14 Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes -- me certifikatë .....	1.00 €
3.1.15 Regjistrimi i martesës (ceremonia e martesës) .....	5.00 €
3.1.16 Regjistrimi i martesës (ceremonia e martesës jashtë objektit të Komunës).....	100.00 €
3.1.17 Kërkesa, Parashtrësia, Ankesa .....	1.00 €
3.1.18. Vërtetim i njetëve për jetesë për botën e jashtme .....	5.00 €
3.1.19 Kopje e dokumentit të vjetër nga Arkiva .....	1.00 €
3.1.20 Kërkesa për ndryshime ose përmirësime në librat AMË-s .....	5.00 €
3.1.21 Kërkesa për ndrrimin e emrit dhe mbiemrit .....	20.00 €
3.1.22 Ndërrimi i emrit dhe mbiemrit për fëmijët deri në 10 vjetë, paguhet .....	5.00 €
3.1.23 Për rikthimin e mbiemrit të vajzërisë paguhet taksa prej .....	3.00 €
3.1.24 Dokumentet e lëshuara nga E-Kiosku.....	1.00 €

### 3.2 Lëshimi i Certifikatave zyrtare përmes ëeb-faqes-postes elektronike-online:

Lloji i dokumentit	Shuma €
3.2.1 Certifikata e lindjes .....	2€
3.2.2 Certifikata e vendëbanimit.....	2€
3.2.3 Certifikata e Martesës.....	2€
3.2.4 Certifikata e Shtetësisë.....	2€
3.2.5 Ekstrakti i lindjes .....	2€

3.3 Bazuar në nenin 63 të Ligjit për Gjendjen Civile, Nr.04/L-003, Me gjobë denohet personi që bën këto shkelje:

3.3.1 ku thuhet: Me gjobë në vlerë prej 20.00 euro (minimumi) dënohet personi që nuk paraqet lindjen e fëmijes në afatën e paraparë me ligj.

3.3.2 ku thuhet: Me gjobë në vlerë prej 50.00 euro (minimumi) dënohet personi që nuk e lajmëron vdekjen në afatin e caktuar sipas ligjit.

3.4 Sipas nenit 3.1 Nga të gjitha pagesat lirohen këta persona: Personat në asistencë sociale, Invalidët e luftës, Familjet e dëshmorëve, Veteranët e luftës (Familja e ngushtë), Ish të burgosurit politik (vetëm individ!), Invalidët civil të luftës (vetëm individ). Personat me aftësi të kufizuar (me anëtarët e ngushtë të familjes).

3.5 Gjithashtu lirohen nga të gjitha pagesat sipas nenit 3.1 edhe rastet që janë në fazën e aplikimit për asistencë sociale e të cilën gjë mund ta dëshmojnë me dokumentin nga Qendra për Punë Sociale se janë në fazë të aplikimit.

3.6 Parashtruesit e kërkesës sipas nenit 3.3 duhet të dëshmojnë se i takojnë njëres nga kategoritë e caktuara si dhe afërsinë familjare me parashtruesin e kërkesës.

3.7 Lirohen nga pagesa e taksës administrative parashtruesit e kërkesës për interes të përgjithshëm për lëshimin e dokumentit nën pikën 3.1.17 dhe 3.1.19 të cilën e bëjnë zyrtarët nga institucionet shtetërore/për nevoja zyrtare shtetërore, Institucioneve Publike, Kryetarët e Fshatrave, Bashkësive lokale, Përfaqësuesit e Shkollave, OJQ-ve, dhe Shoqatave Humanitare.



3.8 Nga pagesa e taksës Administrative lirohen pjestarët e komunitetit RAE në bazë të Memorandunit në mes të KK-Shtime dhe CRP/K (Programi për të Drejtat Civile në Kosovë). Përkatësia etnike e këtyre komuniteteve vërtetohet nga ana e Zyrës për Komunitete (Formulari).

## DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN, KADASTËR DHE GJEODEZI

### 1. Sektori për Urbanizim dhe Ndërtim

#### Neni 4

4.1 Duke u bazuar në Ligjin e Ndërtimit Nr.04/L-110, Udhëzim Administrativ MMPH- Nr.02/18 për Taksat Administrative, për Leje Ndërtimore, Leje Rrënimi dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, përcakton këto tarifa ndërtimore për Sektorin e Urbanizmit dhe Ndërtimit:

4.2 Taksa Administrative për lëshimin e Lejes Ndërtimore -Kategoria I- për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përlogaritur për vitin 2021 është: 1.30€ /m<sup>2</sup>. (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit) Formula: (Tarifa për m<sup>2</sup> x m<sup>2</sup> e ndërtimit= taksa e ndërtimit)

4.3 Taksa Administrative për lëshimin e Lejes Ndërtimore -Kategoria II- për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përlogaritur për vitin 2021 është: 2.00€ /m<sup>2</sup>. (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit) Formula: (Tarifa për m<sup>2</sup> x m<sup>2</sup> e ndërtimit= taksa e ndërtimit)

4.4 Tarifa për rritjen e Densitetit të Infrastrukturës për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përlogaritur për vitin 2021 është: 154.50€. Kjo taksë aplikohet vetëm për njësitë e reja të banimit. (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit)

Formula:

$$\left( \frac{\text{njësia e re banuese}}{\text{(m}^2\text{)}} \right) \times \text{Tarifa rregullati ve për rritjen e densitetit të infrastrukturës për kokë banori} \\ \text{(50)}$$

4.5 Taksa Administrative për Leje Rrënimi për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përlogaritur për vitin 2021 është: 0.70€ /m<sup>2</sup>. (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit) Formula: (Tarifa për m<sup>2</sup> x m<sup>2</sup> e ndërtimit= taksa e rrënimt)

4.6 Taksa Komunale për ndërtim të infrastrukturës, përcaktohet në bazë të nenit 17.1 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, dhe duhet të përcaktohet në bazë të Marrëveshjes për Infrastrukturë në mes aplikantit dhe organit kompetent të përshkruar në ligjin e Ndërtimit Nr.04/L110, neni 23, neni 7,8 dhe 9 i Udhëzim Administrativ MMPH- Nr.02/18 Për Taksat Administrative për Leje Ndërtimore, për Leje Rrënimi si dhe Tarifat për Rregullimin e

Infrastrukturës. Kontrata duhet të jetë ligjërishit e zbatueshme që specifikon termet dhe kushte për sa i përket financimit dhe sigurimit të infrastrukturës.

4.7 Nga nenët e taksave 4.2 dhe 4.3 lirohen ndërtimet e karakterit Bujqësor, Subjektet Afariste në Zonat Ekonomike të Shtime, si dhe të gjitha subjektet afariste që kanë në shfrytëzim pronat e pa luajtshme komunale në bazë të vendimeve për dhënie në shfrytëzim pronën e pa luajtshme komunale.

4.8 Referenca për projektet e realizuara ne Komunën e Shtimes .....10.00 €

#### 4.9 Ndërtimi i objekteve të infrastrukturës:

4.9.1 Për aktin me të cilën lejohet grupimi për ndërtimin e infrastrukturës në hapësirat publike për persona fizik dhe juridik, (jo institucionale dhe donator) si:

4.9.2 Rrjet ujësjellësi (Për metër Gjatësi).....0.30 €

4.9.3 Rrjet kanalizimi (Për metër Gjatësi).....0.30 €

4.9.4 Rrjet elektrike të tensionit të ulët (Për metër Gjatësi).....0.30 €

4.10 Për aktin me të cilën lejohet grupimi për ndërtimin e trasave kabllorike dhe ajrore të infrastrukturës në hapësirat publike për persona fizik e juridik, (jo institucionale dhe donator) si:

4.10.1 Rrjet telekomunikacioni dhe televizive (Për metër Gjatësi).....0.40 €

4.10.2 Rrjete elektrike të tensionit të lartë (Për meter Gjatësi) ..... 0.50 €

4.11 Për aktin me të cilën lejohet ndërtimi i objekteve të infrastrukturës në hapësirat publike për persona fizik dhe juridik, (jo institucionale dhe donator) si:

4.11.1 Antena (GSM) - (Për Copë).....150.00 €

4.11.2 Antena - internet e të ngjajshme - (Për Copë) .....100.00 €

4.11.3 Trafostacionet shtyllë - (Për Copë).....50.00 €

4.11.4 Trafostacionet Blindë - (Për Copë).....100.00 €

### Neni 5

#### Tarifat për shërbimet Online

5.1 Për një përdorues GUI për person tarifa është.....20 €

5.2 Për një përdorues UCËSS si institucion .....100 €

5.3 Mirëmbajtja vjetore për shërbimet e ofruara online është.....200 €

5.4 Përfshirja nga paragrafi 16.3 i këtij neni, bëhet për personat fizik dhe juridik të cilët regjistrojnë të drejtën e hipotekës;

5.5 Bazuar në paragrafin 16.4 të këtij, regjistrimi i hipotekës është 5 euro, ndërsa modifikimi dhe fshirja e saj është pa pagesë.

5.6 Verifikimi i informacioneve për njësi kadastrale është .....2 €

5.7 Verifikimi i informacioneve për person është .....6 €

5.8 Tarifat e përcaktuara në paragrafin 16.6 dhe 16.7 të këtij neni, vlejnë për të gjitha institucionet publike dhe ato private që me ligj kanë autorizime publike.

5.9 Nxjerrja e certifikatave online është .....3 €

5.10 Lirohet nga tarifa për regjistrimin e shënimit nga përdoruesit sipas paragrafit 1 të këtij neni. Përdoruesi nga paragrafi 1 i këtij neni janë të obliguar që të bëjë rexhistrimin e shënimit.

## 2. Sektori për Mjedis

### Neni 6

6.1 Për Leje Mjedisore Komunale zbatohen procedurat në bazë të Ligjit Nr.03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe neni 15 pika 1.1 dhe 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 datë 02.05.2017 për Dhënie e Lejes Mjedisore Komunale.

6.1.1 Për tu paisur me Leje Mjedisore Komunale, aplikuesi duhet të paguaj tarifën prej 0.2% të vlerës investuese mbi 25,000.00 €.

6.1.2 Për tu paisur me Leje Mjedisore Komunale, aplikuesi duhet të paguaj 50.00 € për vlerë investive deri 25,000.00 €

## DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

### Sektori për Inspektorat

#### Neni 7

#### 7.1 Pëlqimi Komunal për aktivitete biznesi:

7.1.1 Lëshimi i Lejes për punë me auto-taxi .....	30.00 €
7.1.2 Vazhdimi i lejeve për auto-taxi .....	10.00 €
7.1.3 Ndarja e vijave të reje të autobusit urban dhe periferik .....	50.00 €
7.1.4 Vazhdimi i linjave të autobusit në trafikun urban dhe periferik.....	30.00 €
7.1.5 Regjistrimi për punë në Kioska .....	15.00 €

#### 7.2 Pëlqimi Higjieniko-teknik e Sanitar për subjektet afariste, mbi bazën e Ligjit për Inspektoriatin Sanitar, Nr.2003/22:

7.2.1 Objektet industriale.....	10.00 €
7.2.2 Shitja e derivateve të naftës (pompat e benzinës), depot e gazrave.....	25.00 €
7.2.3 Restorantet, hotelet, motelet, therrtoret, objektet për prodhimin e ushqimit .....	25.00 €
7.2.4 Ordinancat shëndetsore private, barnatoret mjeksore, barnatoret bujqesore dhe labororet biokimike.....	25.00 €
7.2.5 Vetshërbimet Sh.p.k.....	15.00 €
7.2.6 Kuzhinat (gjelltoret) .....	15.00 €
7.2.7 Ëmbëltoret, Kafiterit.....	15.00 €
7.2.8 Dyqanet tregëtare të pavarura .....	10.00 €
7.2.9 Dyqanet e pavarura zejtare-tregëtare.....	10.00 €
7.2.10 Dyqanet e pavarura zejtare-shërbyese.....	10.00 €
7.2.11 Zyret dhe agjensitë .....	10.00 €
7.2.12 Kiosqet.....	5.00 €
7.2.13 Gurethyesit, Betonjerkat, eksploatuesit e zhavorit .....	1,000.00-20,000.00 €
7.2.14 Veprimtarit Shërbyese në sektorin e Teknologjis Informative dhe produkteve të tyre dhe të gjitha veprimtarit e kësaj lamiye.....	25.00 €

7.2.15 Mos paisja me pelqime sanitare, mjedisore dhe aktet tjera zyrtare do te zbatohen dispozitat ndeshkuese me ligjet, udhezimet dhe rregulloret ne fuqi.

7.2.16 Për zbatimin e kesaj rregulloreje jane kompetent Inspektorati Komunal dhe Policia e Kosovës.

**7.3 Lejet për qarkullimin e automjeteve të rënda motorike në rrugët ku është ndaluar qarkullimi i automjeteve në fjalë, për ngarkim – sbkarkim të mallit mbi 7 tonë:**

7.3.1 Leje në rrugët "T. Sinani" "Komandant Kumanova" dhe "A. Jashari" 1 deri 3 ditë...10.00 €

7.3.2 Leje për të gjitha rrugët tjera - 1 deri 3 ditë .....5.00 €

7.3.3 Leje - 1 deri 15 ditë .....15.00 €

7.3.4 Leje mujore për 1 Kamion.....25.00 €

7.3.5 Leje vjetore për 1 Kamion .....150.00 €

7.3.6 Leje vjetore për çdo Kamion të dytë ose më shumë i shtohen edhe nga .....50.00 €

7.3.7 Të gjithë operatorët që nuk janë të komunës së Shtimes e të cilët furnizohen apo furnizojnë bizneset në komunën e Shtimes duhet të deshmojnë me faturë furnizimin apo shitjen e mallrave nëpër këto biznese që kanë leje qarkullimi mbi 7 tonë, e cila lëshohet për të gjitha veprimtarit e bizneseve në komunën e Shtimes vetëm nëpër rrugët të cilat janë të lejuara me rregullore komunale.

**Neni 8**

**8.1 Taksa për pronësinë në automjet:**

8.1.1 Të gjithë pronarët – poseduesit e automjeteve motorike në Komunën e Shtimes të cilat rrexhistrohen duhet të paguajnë taksën Komunale sipas kësaj table:

Nr.	Emërtimi – Lloji i Automjeteve	Shuma €
1.	-Të gjitha Automjetet me peshë të përgjithshme deri në 3500 kg. -Të gjitha llojet e Motoçikletave që rrexhistrohen.	10.00
2.	- Të gjitha Automjetet me peshë të përgjithshme mbi 3500 kg. - Të gjithë Autobusët dhe Minibusët.	20.00
3.	- Lirohen nga pagesa të gjitha llojet e Rimorkios, Traktorët dhe mjetet tjera bujqësore.	00.00

**8.2 Nga Taksa për pronësinë në automjet lirohen:**

8.2.1 Automjetet e: Emergjencës, Zjarëfiksave, Policisë, Komunës, Shoqatave jo qeveritare, Ushtarake, dhe të organizmave ndërkombëtarë - Dëshmi për këtë është Librezja e Automjetit.

8.2.2 Familja e ngushtë e Dëshmorëve të UÇK-së, dhe Invalidët e luftës së UÇK-së;

8.2.3 Personat me Invaliditet ushtarak dhe të punës, dëshmi për këtë është: Vendimi mbi Invaliditetin nga Ministria e Punës.

8.2.4 Personat me aftësi të kufizuara, dhe Ish të burgosurit politik.

8.2.5 Veteranët e UÇK-së

8.2.6 Lirimi nga taksat sipas kësaj Rregulloreje, bëhet pasi që pala të prezantoj dëshmi valide për statusin përkatës.

**8.3 Taksa Komunale për shfrytëzimin e Pronës Komunale me destinacion të përkohshëm:**

8.3.1 Kiesqet (Qoshqet), Objektet Montazh etj. në Komunën e Shtimes janë të obliguar të paguajnë taksën për një Muaj sipas kësaj table:

Nr.	Zonat	Sasia	Çmimi për 1 Muaj
1	Zona e parë	1 m <sup>2</sup>	2 €
2	Zona e dytë	1 m <sup>2</sup>	1 €
3	Zona e tretë	1 m <sup>2</sup>	0.5 €
4	Zonat rurale	1 m <sup>2</sup>	0.5 €

#### 8.4 Taksat për shfrytëzimin e hapësirave të tregut sipas llojeve paguhën sipas kësaj tablele:

Nr	Tregu	Përshkrimi	Ditët	Njësia matëse	Çmimi për Një Ditë €	Çmimi për Një Vit (Rezervim)
1.	I Plaçkave dhe i gjelbër	Tezgë – Lokacion për shitje të Mallit	E premtë	1 m <sup>2</sup>	1.00	(2 m <sup>2</sup> ) 100.00 €
2.	I Plaçkave dhe i gjelbër	Tezgë – Lokacion për shitje të Mallit	Për ç' do ditë	1 m <sup>2</sup>	0.50	(2 m <sup>2</sup> ) 150.00 €
3	Hapsira Publike	Shfrytëzimi i Lokacionit (polygon) për Autoshkolla	Në Treg, përveç ditës e Premtë	Paushall	/	Çmimi për një Muaj 30€
4.	I Kafshëve	Shitja e Kafshëve të trasha	E premtë	1 Copë	2.00	/
5.	I Kafshëve	Shitja e Kafshëve të imëta	E premtë	1 Copë	0.50	/
6.	I Gjelbër dhe kafshëve	Shitje me Kamionë, Qerre, Rimorkio, etj.	E premtë	1m. gjatësi	1.00	/
7.	I Gjelbër dhe kafshëve	Shitje me Kamionë, Qerre, Rimorkio, etj.	Për ç' do ditë	1m. gjatësi	0.50	Deri 3500 kg - 100.00€ Mbi 3500 kg - 150.00€
8.	I Plaçkave dhe i gjelbër	Parkimi i automjeteve	Përveç e Premtë e Shtun e Dielë	1 Copë	0.50	/
9.	I Kafshëve	Peshorja e kafshëve	Për një vit	Paushall	/	150.00€

VËREJTJE: Zhavorri ose materiali tjetër ndërtimor nuk është i lejuar të zbrazet në tokë, në lokacionin e tregut.

#### 8.5 Taksat për shfrytëzimin e hapësirave publike në Komunën e Shtimes, paguhën sipas kësaj tablele:

MBI BAZËN E PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE, DHE LEJES TË LËSHUAR NGA ORGANI KOMPETENT I ADMINISTRATËS KOMUNALE PAGESA KRYHET NË VALUTËN EURO PËR NJË METËR KATROR SIPËRFAQE KOMUNALE-PUBLIKE QË SHFRYTËZOHET - SIPAS KËSAJ TABELLE:					
Për Muaj	PAGESA SIPAS ZONAVE -E				SHFRYTËZIMI I PËRKOHSHËM I HAPSIRAVE KOMUNALE-PUBLIKE:
	Zona I	Zona II	Zona III	Zona Rurale	
1	5	4	3	2	1. Shitje sezonale të Lëvizshme, ( Frigorifer, Fara, Cigare etj) 2. Vendosje të Panairëve, Tregje dhe Reklamim të automjeteve, 3. Shfrytëzimi i sipërfaqes për Reklam. të mallrave të ndryshëm 4. Vendosja e Reklamave, pagesa për metër katror të reklamës, 5. Vendosja e Verandave, Pushimoreve, Çadrave për biznese etj, 6. Vendosje të pajisjeve për lojëra të ndryshme dhe argëtim, 7. Vendosje të përkohshme të pajisjeve dhe materialit për ndërtim. 8. Vendosje të Kontejnerëve për mbeturina ricikluese për m <sup>2</sup> . 9. Shfrytëzimi i sipërfaqes- hapësirës publike për nevoja të
2	8	6.40	4.80	3.20	
3	12	9.60	7.20	4.80	
4	16	12.80	9.60	6.40	
5	20	16	12	8	
6	24	19.20	14.40	9.60	
7	28	22.40	16.80	11.20	
8	32	25.60	19.20	12.80	
9	36	28.80	21.60	14.40	

10	40	32	24	16	ndryshme të qytetarëve. 0. Pajesa për parkimin e automjetit, dhe me rimorkio në Parkingun Publik në Rrugën kryesore - Shtime është 0.20€ (Njëzet cent) për një orë.
11	44	35.20	25.40	17.60	
12	48	38.40	28.80	19.20	

8.6 Për dhënie e Objekteve të mëdha ose sipërfaqeve të tokës, Komunale-Publike me qira ose në formë tjera për shfrytëzim afatshkurtë ose afatgjatë, kërkesa e palës duhet të i nënshtrohet procedurës administrative, sipas Ligjeve pozitive të Republikës së Kosovës dhe Rregulloreve të Komunës së Shtëmës, dhe për të vendos Kuvendi i Komunës ose Organet e tij.

**8.7 Tarifat fikse (Pa-TVSH) për kryerjen e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave Mikse (të përziera) në Komunën e Shtëmës.**

**Amvisëritë**

8.7.1 Amvisëritë paguajnë tarifën mujore në shumën prej .....5.99 €  
Komerciale/Industriale

8.7.2 Kategoria -I- Përfshihen, Dyqanet e vogla dhe artizanale të cilat paguajnë shumën mujore prej.....9.59 €

8.7.3 Kategoria -II- Përfshihen, Bizneset e mesme deri të mëdha me kosto të ulët të shërbimit të cilat paguajnë shumën mujore prej.....13.54 €

8.7.4 Kategoria -III- Përfshihen, Bizneset e mesme deri të mëdha me kosto të moderuar të shërbimit të cilat paguajnë shumën mujore prej.....23.60 €

8.7.5 Kategoria -IV- Përfshihen, Bizneset e mesme deri të mëdha me kosto të lartë të shërbimit të cilat paguajnë shumën mujore prej.....31.16 €

Bizneset me kontrata të Veqanta

8.7.6 Kategoria -V- Për Kontejnerët 1.1 m<sup>3</sup>, paguajnë për ç'do zbrazje shumën.....15.58 €

8.7.7 Kategoria -V- Për Kontejnerët 5.1 m<sup>3</sup>, paguajnë për ç'do zbrazje shumën.....66.11 €

Institucionet me kontrata të Veqanta

8.7.8 Kategoria -V- Për Kontejnerët 1.1 m<sup>3</sup>, paguajnë për ç'do zbrazje shumën.....15.58 €

8.7.9 Kategoria -V- Për Kontejnerët 5.1 m<sup>3</sup>, paguajnë për ç'do zbrazje shumën.....66.11 €

## DREKTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

### Sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

#### Neni 9

**9.1 Kompensimi për shndërrimin e tokës bujqësore në jobujqësore**

9.1.1 Me këtë bëhet caktimi ndryshimit të destinimit të sipërfaqeve bujqësore sipas Udhëzimit Administrativ, Nr.41/2006, lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

9.1.2 Në komunën e Shtëmës sipas strukturës së sipërfaqeve bujqësore ekzistojnë tetë klasë.

9.1.3 Kompensimi për ndryshim të destinimit të Tokës sipas klasave bëhet sipas tabelës në vijim:

Klasa I-rë deri IV-të	Kompensimi	1.00 €/m <sup>2</sup>
Klasa V-të dhe VI-të	Kompensimi	0.75 €/m <sup>2</sup>
Klasa VII-të dhe VIII-të	Kompensimi	0.50 €/m <sup>2</sup>

9.1.4 Përcaktimi i këtyre kuotave financiare sipas kategorive dhe klasave është rezident vetëm për zonën urbane të ndarë në tri zona.

9.1.5 Përjashtime nga neni 8.1.4 mund të bëhen vetëm për rastet kur ndërrimi i destinimit të tokës ka të bëjë me ndërtimin e Objekteve bujqësore, Fermave, Fidanishteve, Serrave e objekteve me karakter zhvillimi të bujqësisë.

9.1.6 Vërtetim për marrje me veprimtari bujqësore, kompensimi për persona fizikë .....2.00 €

### 9.2 Shërbimet Profesionale për prerje të Pyjeve Private

9.2.1 Dru zjarri për m<sup>3</sup> në shumën prej .....1.50€

9.2.2 Dru zjarri mbi 7 m<sup>3</sup> në shumën prej .....2.00€

9.2.3 Dru teknik për m<sup>3</sup> në shumën prej .....3.00€

### 9.3 Lartësia e taksës për shfrytëzimin e kullosave

Nr	Lloji i Bagëtisë	NB / për kokë	Euro / për kokë
1	Cjdhët mbi një vit	1	1.20
2	Viçat	0.45	0.54
3	Delet	0.18	0.22
4	Cengjat	0.1	0.12
5	Kuajtë – Gomarët	1	1.20
6	Dosat	0.5	0.60
7	Derrat	0.3	0.36
8	Rosat	0.014	0.02

### Sektori për Zhvillim Ekonomik

#### 9.4 Certifikata që ka të bëjë me vlerësimin e pronës dhe kapitalit:

9.4.1 PAGESA NË RASTIN KUR LËSHOHET NGA ZYRA MBI PROVA (DOKUMENTACIONIT) .....5.00 €

9.4.2 PAGESA NË RASTIN KUR DUHET BËRË VLERËSIMIN PËRMES KOMISIONIT PROFESIONAL NË TEREN DHE KUR DËHET SAJUAR PROCESVERBALIN PËRKATËS .....25.00 €

9.4.3 Vërtetime të ndryshme .....1.00 €

### DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

#### Neni 10

#### 10.1 Tarifat Komunale për dokumentat që lëshon DSHMS-ë dhe QPS-ë:

10.1.1 Vërtetim për Dëshmorët.....(lirohen)

10.1.2 Formulari për trajtim jashtë vendit.....(lirohen)

10.1.3 Vërtetimi për skemën invalidore dhe të plagosurit e luftës.....(lirohen)

10.1.4 Vërtetim nga participimi.....(lirohen)

10.1.5 Vërtetim i gjendjes Sociale.....1.00 €

10.1.6 Vërtetimet tjera .....1.00 €

10.1.7 Vërtetim që nuk i është marrë e drejta për të vepruar apo e drejta prindore .....2.00 €

10.1.8 Vërtetim që familja nuk merr asistencë sociale (për shtetet e jashtëme) .....2.00 €

10.1.9 Vërtetim (mendimi) për martesë të parakohshme .....3.00 €

10.1.10 Vërtetim për rexhistrim të më vonshëm të fëmijëve .....2.00 €

10.1.11 Vërtetim që është duke u kujdesur për fëmijë .....2.00 €

10.1.12 Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e punës dhe veprimt .....2.00 €

10.1.13 Pëlqim për bartjen e pasurisë .....2.00 €

10.1.14 Pëlqim për udhëtim jashtë vendit për fëmijët e moshës jo madhore .....2.00 €

10.1.15 Kërkesë për përfaqësim në Gjykata për fëmijët lidhur me trashëgimi.....3.00 €

10.1.16 Konstatime të ndryshme zyrtare .....3.00 €

10.1.17 Pranim i Atësisë dhe Amësisë .....3.00 €

10.2 Duke u bazuar në U.A. Nr.04/2007 të datës 24.09.2007, dhe U.A.Nr. 04/2013 të datës 15.05.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave për mbledhjen dhe shfrytëzimin e mjeteve nga bashkëpagesa e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të institucioneve shëndetësore, çmimorja e pagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor është:

10.2.1 Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë .....	1.00 €
10.2.2 Egzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të Familjes.....	2.00 €
10.2.3 Egzaminimi specialistik në QMF/QKMFpa udhëzim të Mjekut të Familjes.....	5.00 €
10.2.4 Egzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente .....	6.00 €
10.2.5 Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoren publike .....	0.30 €
10.2.6 Ultrazëri Standard .....	2.00 €
10.2.7 Radiografia .....	2.00 €
10.2.8 EKG .....	0.50 €
10.2.9 Analizat Laboratorike-vetëm hemogrami dhe urina .....	1.00 €
10.2.10 Analizat laboratorike (komplet) .....	3.00 €
10.2.11 Caktimi i sheqerit në gjak me glikometer sipas kërkeses së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore .....	1.00 €
10.2.12 Audiogrami .....	1.00 €
10.2.13 Shpërlarja e veshit .....	1.00 €
10.2.14 Dhënja e injeksionit Intra muskular në shtëpi ,përpos në rastet emergjente .....	1.00 €
10.2.15 Dhënja e injeksionit Intra venoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente .....	1.00 €
10.2.16 Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm në viziten e parë) .....	3.00 €
10.2.17 Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor .....	1.00 €
10.2.18 Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për Çertifikatat Shëndetësore Nr.04/2013, bëhet lëshimi i Çertifikatave të shëndetësisë në Kujdesin Primar .....	15.00 €
10.2.18.1 Çertifikata shëndetësore për edukim dhe shkoillim ( Lironen nga pagesa në sektorin publik, bazuar në Ligjin për shëndetësi, përjashtohen moshat mbi 26 vjet dhe shtetasit e huaj).....	10 €
10.2.18.2 Çertifikata shëndetësore për punësim.....	15 €
10.2.19 Dhënja e raportit mjekësor ,vertetimit apo dokumentit tjetër ne baze te kerkeses se shfrytezuesit te sherbimeve shendetsore .....	5.00 €
10.2.20 Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjate aktivitetve sportive, etj. - per nje orë .....	25.00 €
10.2.21 Vizite e parë stomatologjike .....	1.00 €
10.2.22 RTG i dhëmbit .....	1.50 €
10.2.23 Mbushje e përhershme me amalgam .....	4.00 €
10.2.24 Mbushje e përhershme me kompozitë .....	5.00 €
10.2.25 Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë).....	5.00 €
10.2.26 Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë).....	6.00 €
10.2.27 Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë).....	6.00 €
10.2.28 Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë).....	6.00 €
10.2.29 Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë).....	6.00 €
10.2.30 Terapia e kanalit të infektuar të përhershme (amalgam apo kompozitë).....	6.00 €
10.2.31 Rindërtimi konzervativ i dhëmbit me bushje të përhershme.....	6.00 €
10.2.32 Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjes.....	1.00 €



12.1.6 Lirohen nga pagesa për pjesëmarrje në aktivitetet kulturore këto kategori: fëmijet e dëshmorëve, fëmijet e invalidëve të luftës, fëmijet e veteranëve, pensionistet, rastet sociale, personat me aftësi të kufizuara dhe vullnetarët që posedojnë dëshmi sipas kategorisë së përcaktuar.

**12.2 Pagesat për shfrytëzimin e objekteve dhe fushave sportive:**

12.2.1 Shfrytëzimi i Sallës për aktivitete sportive, rekreative për 1 orë..... 10.00 €/orë

12.2.2 Shfrytëzimi i Sallës për aktivitete josp sportive për 1 orë ..... 20.00 €/orë

Për aktivitetet në Stadionin e qytetit pagesat bëhen:

12.2.3 Shfrytëzimi i Stadionit për aktivitete sportive, rekreative për 1 orë .....10.00 €/orë

12.2.5 Shfrytëzimi i Stadionit për aktivitete josp sportive për 1 orë .....20.00 €/orë

12.2.6 Lirohen nga pagesa për shfrytëzimin e objekteve sportive këto kategori: të gjitha klube sportive lokale të licencuara nga DKRS, të gjitha institucionet komunale të arsimit.

### **III DISPOZITAT NDËSHKUESE**

#### Neni 13

"Mospagesa për shfrytëzimin e pronës Komunale parasheh masën ndëshkuese, ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë për personat fizik, ndërsa për personat juridik mund të parashihet vetëm sanksioni kundërvajtës me gjobë, sipas legjislacionit përkatës në fuqi për kundërvajtjet, respektivisht neni 29 (paragrafi 4 dhe 5) të Ligjit Nr.05/L-087 për Kundërvajtjet".

### **IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### Neni 14

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, zhbëzohet Rregullorja Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023, me numër Npi-91/78 datës: 15.03.2023.

#### Neni 15

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisjen Lokale, dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

#### Neni 16

Implementimin e kësaj rregullore janë të obliguar ta bëjnë: Kryetari, të gjitha Drejtoritë Komunale si dhe të gjitha Institucionet në nivelin e lokal të Komunës së Shtimes.

#### Neni 17

Rregullorja dhe Vendimi u dërgohen: Arkivit, Drejtorive, Institucioneve lokale, Kryetarit të Komunës, MAPL, MEF dhe Zyrës për Informim.

Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi

v.v.




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim,  
Uprava za Obrazovanje /Department of Education

DATE	20.02.2024
NR.	05/68
PËR	z. Adnan Ademi, kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA	Yllka Fejzullahu, drejtoreshë e DKA-së
LËNDA	SHKRESË PËRCJELLËSE



Përmes kësaj shkrese po e paraqesim për procedim të mëtejshëm në Kuvendin e Komunës Draft-Planin e Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024/2026.

*Me respekt!*

Adresa: Rr. Tiranës, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.

Draft- Plani Komunal i Veprimit kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME

OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Arsimit

Uprava za Obrazovanje//Department of Education

**DRAFT-PLANI I VEPRIMIT KUNDËR BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË  
SHKOLLËS 2024-2026**

Piani Komunal i Veprimit kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkolës 2024-26

**Përmbajtja**

Lista e shkurtesave

.....

Hyrje

.....

Konteksti

.....

Qëllimi i planit të veprimit.

.....

Oëjektivat

.....

Shtojca.....

## Plani Komunal i Veprimt kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

### Sbkurtesat

MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
DKA	Drejtoritë Komunale të Arsimit
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informacioneve në Arsim
EPRBM	Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit
KN	Këshilli i nxënësve
KP	Këshilli i prindërve
KPAK	Komiteti i Prindërve të Arsimit të Kosovës
QPS	Qendra për Punë Sociale
OJQ	Organizatë Joqeveritare
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
ECMI	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve

### HYRJE

Janë një varg konventash dhe standardesh ndërkombëtare, të cilat kërkojnë qasje dhe mundësi të barabartë në arsim cilësor, prandaj shteti ka detyrim të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar të drejtën e arsimit për të gjithë qytetarët e vet pa dallim gjinie, etnie, aftësie e gjendje tjetër.

Meqë po flasim për shkollat dhe nxënësit/fëmijët e arsimit parauniversitar, po i referohemi ekskluzivisht **Konventës për të Drejtat e Fëmijës**, si traktati që i mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse të drejtat e fëmijës në çdo cep të botës. Duke u thirrur në parimet bazë të kësaj

## Plani Komunal i Veprimt kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

konvente, shtetet orientojnë politikat nacionale, prandaj ato janë bazamenti i të drejtave universale për çdo fëmijë/ individ: **Mosdiskriminimi, Pjesëmarrja, Interesi më i lartë i fëmijës dhe Zhvillimi i potencialit të plotë.**

Bazuar në këto parime, institucionet arsimore duhet të kujdesen për pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje në arsim cilësor, duke siguruar zhvillimin e fëmijëve brenda potencialit të plotë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Nenin 47) dhe legjislacioni i arsimit garantojnë të drejtën e arsimimit për të gjithë pa dallim gjinie, etnie, aftësie a gjendje tjetër, duke pasur për bazë të drejtat e njeriut/fëmijës.

Ligjet aktuale: Ligji për Edukimin Parashkollor, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional, Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur, Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, Ligji për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës, etj, bashkë me aktet nënligjore përcjellëse adresojnë mundësitë e barabarta dhe qasjen e gjithëpërfshirëse në arsim cilësor.

Barrierat e natyrave të ndryshme brenda sistemit arsimor, sidomos ato të qasjes në arsim, ndërlidhur me faktorët e shumtë individualë, familjarë, shoqërorë me kontekste të ndryshme sociale, ekonomike, shëndetësore e kulturore, kërkojnë qasje multidisiplinare, prandaj i kemi ligjet tjera relevante si: Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Kodi i Përkonshëm i Procedurës Penale, Ligji i Policisë, shëndetësisë etj, që bashkë me rregulloret dhe mekanizmat tjerë institucionalë, na e kërkojnë bashkëveprimin e plotë për të funksionuar si hallka të shtetit në adresimin e problemeve me të cilat ballafaqohemi.

Legjislacioni i arsimit, obligon institucionet përgjegjëse si: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, komunitat, institucionet arsimore dhe komunitetin, që të marrin të gjitha hapat e arsyeshëm që institucionet arsimore të jenë cilësore, gjithëpërfshirëse, humane dhe të sigurta, siç e kërkojnë politikat arsimore, përfshirë standardet për shkollat mike, kurrikulat dhe secila hallkë e sistemit arsimor. Janë një varg aktesh nënligjore që ndihmojnë zhvillimin e procedurave për sigurimin e qasjes e barabartë në arsim, zbatimin e ligjeve në fuqi.

Pastaj kemi dokumentet strategjike relevante që për prioritet kanë pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen në arsim, si dhe dokumentet tjera strategjike ndërsektorale dhe procedurat

## Piani Komunal i Veprimt kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

standarde që adresojnë aspektet e qasjes në arsim të viktimave të trafikimit, dhunës, krimit dhe rrethanave tjera çfarëdo qofshin ato.

Në funksion të zbatimit të këtyre politikave dhe konkretisht në adresimin e pjesëmarrjes në arsim ne me këtë plan komunal përqendrojmë vëmendjen te parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, për të siguruar që të gjithë fëmijët, të jenë përfitues të sistemit arsimor dhe të zhvillohen brenda potencialit të plotë.

### Konteksti

Në komunën e Shtimes funksionojnë 7 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta dhe 2 shkolla të mesme të larta, dhe në nivelet e shkollimit 1,2 dhe 3 në vitin shkollor 2023-2024 vijnë mësimin gjithsej 4512 nxënës duke mos përfshirë nivelin 0 (edukimin parafillor).



■ KI 1-5 ■ KI 6-9 ■ KI 10-12

## Plani Komunal i Veprimit kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

### SHKOLLA E FILLORE

Në gjithsej 7 institucione edukativo-arsimore të cilat janë: 1. SHFMU "Abdullah Shabani" në Carralevë, 2. SHFMU "Bajram Curi" në Petrovë, 3. SHFMU "Emin Duraku" në Shtime që funksionon në dy shkolla të ndara përkatësisht niveli 1 zhvillon mësimin në një objekt ndërsa niveli 2 në një objekt tjetër shkollor, 4. SHFMU "Hasan Prishtina" në Godanc, 5. SHFMU "Idriz Ajeti" në Pjetërshticë, 6. SHFMU "Lasgush Poradeci" në Muzeqinë dhe 7. SHFMU "Skënderbeu" në Reçak.

Në arsimin fillor, përkatësisht nivelin 1 të shkollimit (klasa 1 deri në 5) në vitin shkollor 2023-2024 vijnë mësimin gjithsej 1992 nxënës prej të cilëve 958 vajza dhe 1034 djem, nxënës të cilët kanë braktisur shkollimit gjatë këtij viti shkollor në këtë nivel nuk ka. Nxënës pa njërin prind në këtë nivel të shkollimit janë 32 gjithsej, ndërsa pa dy prindër është një nxënës. Nxënës që kanë vështirësi në të nxënë janë gjithsej 78, numri i nxënësve të cilët kanë mungesa të shumta gjatë këtij viti shkollor që përfshihet periudha kohore më shumë se një javë mungesë pa arsye janë 19, ndërsa nxënës të cilët paraqesin rrezik për braktisje është 1. Në këtë nivel të shkollimit nuk ka tendencë apo rrezik të braktisjes së shkollimit andaj edhe nuk paraqiten faktorë apo shkaqe që parashohin një rrezik të tillë.

### SHKOLLA E MËSME E ULËT

Në gjithsej 7 institucione edukativo arsimore të cilat janë: 1. SHFMU "Abdullah Shabani" në Carralevë, 2. SHFMU "Bajram Curi" në Petrovë, 3. SHFMU "Emin Duraku" në Shtime që funksionon në dy shkolla të ndara përkatësisht niveli 1 zhvillon mësimin në një objekt ndërsa niveli 2 në një objekt tjetër shkollor. 4. SHFMU "Hasan Prishtina" në Godanc, 5. SHFMU "Idriz Ajeti" në Pjetërshticë, 6. SHFMU "Lasgush Poradeci" në Muzeqinë dhe 7. SHFMU "Skënderbeu" në Reçak.



## Plani Komunal i Veprimt kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

Në arsimin e mesëm të ulët përfatësisht nivelin 2 të shkollimit (klasa 6 deri në 9) në vitin shkollor 2023-2024 vijojnë mësimin gjithsej 1533 nxënës prej të cilëve 739 vajza dhe 794 djem, nxënës të cilët kanë braktisur shkollimit gjatë këtij viti shkollor janë gjithsej: 6. Nxënës pa njërin prind në këtë nivel të shkollimit janë 18 gjithsej, ndërsa pa dy prindër është një nxënës. Nxënës që kanë vështirësi në të nxënë janë gjithsej 19, numri i nxënësve të cilët kanë mungesa të shumta gjatë këtij viti shkollor që përfshihet periudha kohore më shumë se një javë mungesë pa arsye janë 31, ndërsa nxënës të cilët paraqesin rrezik për braktisje janë 20. Në këtë nivel të shkollimit faktorë dominant që paraqesin rrezik të nxënësve për braktisje kryesisht mund të konkludohet se janë: Përsëritja e klasës, kushtet e rënda ekonomike-sociale të disa familjeve, nxënës në familje në të cilat shfaqen probleme bashkëshortore si shkurorëzime etj. Sfidat kryesore të komunës janë mungesa e stafit të mjaftueshëm në Qendren për Punë Sociale të cilët do të trajtonin rastet e cënueshme.

### SHKOLLA E MESME E LARTË

Në komunën e Shtimes janë dy shkolla të mesme të larta: 1. SHML Gjinnazi "Naim Frashëri" në Shtime dhe Institucioni i Arsimit dhe Afërsimit Profesional në Shtime.

Në arsimin e mesëm të lartë përkatësisht nivelin 3 të shkollimit (klasa 10 deri në 12) në vitin shkollor 2023-2024 vijojnë mësimin gjithsej 987 nxënës prej të cilëve 481 vajza dhe 506 djem, nxënës të cilët kanë braktisur shkollimit gjatë këtij viti shkollor janë gjithsej: 6. Nxënës pa njërin prind në këtë nivel të shkollimit janë 17 gjithsej, ndërsa pa dy prindër janë 5 nxënës.

Nxënës që kanë vështirësi në të nxënë është gjithsej 1, numri i nxënësve të cilët kanë mungesa të shumta gjatë këtij viti shkollor që përfshihet periudha kohore më shumë se një javë mungesë pa arsye janë 5, ndërsa nxënës të cilët paraqesin rrezik për braktisje janë 16. Në këtë nivel të shkollimit faktorë dominant që paraqesin rrezik të nxënësve për braktisje kryesisht mund të konkludohet se janë: Përsëritja e klasës, kushtet e rënda ekonomike-sociale të disa familjeve, nxënës në familje në të cilat shfaqen probleme bashkëshortore si shkurorëzime etj. Sfidat kryesore të komunës janë mungesa e stafit të mjaftueshëm në Qendrën për Punë Sociale, të cilët do të trajtonin rastet e cënueshme.

### Qëllimi i planit të punës

## Plani Komunal i Veprimit kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

Koordinimi i veprimeve ndërinstytucionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes.

### Objektivat e Planit Komunal të Veprimit

- **Objektiva e përgjithshme I:** Parandalimi dhe identifikimi i hershëm i nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ata, si këshillim, mbështetje dhe mentorim

#### Objektivat specifike:

- 1.1. Funkcionalizimi i EPRBM-ve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i braktisjes në nivel komune;
- 1.2. Koordinimi ndërinstytucional dhe me partnerë zhvillimorë në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave;
- 1.3. Monitorimi i progresit akademik dhe joakademik i nxënësve dhe t'u ofrohet atyre mbështetje kur është e nevojshme.

- **Objektiva e përgjithshme II:** Ulja e përqindjes së e braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitë e karrierës që përputhen me aftësitë, dhe interesat e nxënësve

#### Objektivat specifike:

- 2.1. Urëzimi mes shkollës së mesme të ulët me shkollën e mesme të lartë duke filluar nga klasa e 6-të
- 2.2. Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orinetimin në profile sipas kompetencave dhe interesave të fëmijës;
- 2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të mentorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës

## Plani Komunal i Veprimit kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

### 2.4. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit.

Këto objektiva janë detajuar me aktivitete, indikatorë, afate kohore, institucione përgjegjëse dhe mbështetëse, si dhe me buxhetin e planifikuar, ashtu që lehtësisht monitorohen në faza periodike.

#### Rezultatet kryesore të pretenduara:

- Rritja e monitorimit dhe mbikëqyrjes
- Funkcionalizimi i EPRMB në Komunë dhe në të gjitha shkollat
- Në fund të secilit vit pretendojmë rezultate konkrete për numrin / përqindjen e rasteve të zgjidhura
- Përgjigjja ndaj rasteve të nx. të panotuar dhe me shumë mungesa
- Rritja e raportimit cilësor nga shkollat/zvogëlimi i braktisjes

#### Buxheti:

Buxheti i paraparë në këtë plan arrin deri në 49.550 €. (për 3 vite)

#### Monitorimi:

Zbatimin e këtij plani e monitoron EPRBM-ja komunale, e cila bën raport vjetor mbi zbatimin e planit. Ky plan veprimi do të shoqërchet me kornizë monitoruese, e cila do ta lehtësojë procesin e monitorimit dhe raportimin në afatet e përcaktuara, gjashtëmujore dhe vjetor

## Draft- Plani Komunal i Veprimit kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

Nr.		Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
				2024	2025	2026			
Objektiva e përgjithshme 1. Fuqizimi i EPRBM-ve për parandalim dhe identifikim të hershëm të nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ato, si këshillim, mbështetje dhe mentorim									
Objektiva specifike 1.1: Funkcionalizimi i EPRBM-ve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i braktisjes në nivel komune									
1.1.1	Funksionalizimi i EPRBM-së komunale me takime dhe raportime të rregullta	Vendimi, procesverbalet, agjendat	X			DKA	Komuna MASHTI	0 €	
1.1.2	EPRBM në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar janë të themeluara	Vendimet e EPRBM-ve shkollore, 10 institucione edukativo-arsimore në Shtime	X			DKA	MASHTI Partnerët	0 €	
1.1.3	Seanca mbështetëse për EPRBM-në komunale	Agjendat, listat e pjesënarjes, procesverbalet rekomandimet, 5	X	X		DKA	MASHTI Partnerët	1500 €	

Plani Komunal i Veprimt kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

Objektiva specifike/1.2. Koordinimi ndërinstytucional dhe me partnerë zhvillimorë në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave dhe nxënësve në nevojë							
Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
		2024	2025	2026			
1.2.1 Takime koordinues me partnerë	5 takime në vit, marrëveshjet e bashkëpunimit	x	x	x	DKA	MASHITI Partnerët	150 €
1.2.2 Zhvillimi i projekteve ndërsektoriale në parandalim të dukurive negative që e sfidojnë vijimin e rregullt të shkollës të gupeve të caktuara të nxënësve	aktivitete ndërregjësues në vit, 10 shkolla përfituese		x	x	DKA	Drejtoritë tjera komunale DSHMS, Zyra për Komunitete dhe Kthim, Policia në Bashkësi Partnerët	500 €
1.2.3 Mbështetja e nxënësve me stimuj	Nr. i bursave		x		DKA	Partnerët	25.000 €

Plani Komunal i Veprimit kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

të tjerë (shpërblime) për motivimin e shkollimit të qëndrueshëm.		50 bursa në vit. 50 nxënës përfitues në ShML-të	X	X	X	X	Pedagogët, psikologët e shkollave	DKA Shkollat	0.00 €
1.2.4.	Ligjërata në shkolla nga pedagogët/psikologët e shkollave për dukurinë e braktisjes	4 ligjërata në shkolla të mesme të larta profesionale/vit	X	X	X	X	DA Shkolla	Komuna	3.000.00 €
1.2.5	Fushata sensibilizuese për regjistrimin e nxënësve	Broshura Postera	X	X	X	X	MASHTI DA	MASHTI DA	1.500.00€
1.2.6	Aktivitete ndërgjegjësuese për punën e lejuar të nxënësve në shkollat e mesme të larta pa e penguar procesin mësimor	Lista e nxënësve që punojnë	X	X	X	X	MASHTI DA	MASHTI DA	1.500.00€
Objektiva specifike 1.3: Monitorimi i progresi akademik dhe joakademik i nxënësve dhe t'u ofrohet atyre mbështetje kur është e nevojshme.									
Aktivitetet		Treguesit	Afati kohor		Institucioni		Institucionet		Buxheti
			2024	2025	2026	përgjegjës		mbështetëse	

Plani Komunal i Veprimt kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

1.3.1.	Takimet e rregullta me prindërit, mësuesit dhe administratorët e shkollave për të rishikuar përparimin akademik dhe joakademik të nxënësve		X	X	X		Shkolla	DA	500 euro
1.3.2.	Sigurimi i fondeve për aktivitetet mbështetëse për nxënësit që kanë vështirësi akademike ose personale;	Buxheti i ndalë Aktivitate e realizuara	X	X	X		DKA Shkollat	MASHTI MEF	1,500,00€
1.3.3	Zbatimi i sistemit kombëtar për identifikimin dhe adresimin e faktorëve të rrezikut për braktisjen e shkollës, si mungesat në shkollë, performancë e dobët akademike dhe çështjet e sjelljes.	SPH funksional dhe i përdorshëm nga të gjitha shkollat	X	X	X		Shkollat DA	MASHTI Partnerët	700,00€
<p><b>Objektiva e përgjithshme 2. Ulja e përqindjes së e braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitë e karrierës që përputhen me aftësitë, dhe interesat e nxënësve.</b></p>									
<p><b>Objektiva specifike 2.1: Urëzimi mes shkollës së mesme të ulët me shkollën e mesme të lartë duke filluar nga klasa e 6-të</b></p>									
Nr.	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor	Buxheti					

Plani Komunal i Veprimt kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

			2024	2025	2026	Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	
2.1.1	Zbatimi i politikave për orientimin në karrierë në fazat e hershme dhe me fokus për nxënësit e klasës së 6-të.	U.A. i zbatueshëm Aktivitet i rregullta, të realizuara	x	x	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	0.0 euro
2.1.2	Organizimi i panairëve të karrierës për t'i ekspozuar nxënësit para profesioneve të ndryshme dhe mundësi punësimit. Udhëzimi administrativ për keshilltar të karrierës Broshura	Panairët e realizuara	X	x	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	5000 €
2.1.3	Hartimi i një programi që i ndihmon nxënësit në planifikimin e karrierës dhe vendim marrjen, i cili	Programi i hartuar dhe i shpërndarë në shkolla		x	X	Shkollat DA	MASHTI Partnerët	500 euro



## Plani Komunal i Veprimtari kundër Braktisë dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti	
		2024	2025	2026				
2.1.4	Përfshin lidhjen e tyre me shkollat e mesme të larta.							
2.1.4	Organizimi i vizitave të nxënësve të klasave 6-7 dhe 8-9 në shkollat e mesme të larta	Presëmarrja e nxënësve	X	X	X	DA SHFMU	DA Shkollat e mesme të larta	1500 euro
2.1.5	Organizimi i vizitave të nxënësve të klasave të nënta në biznese	Presëmarrja e nxënësve	X	X	X	DA	DA SHFMU	500 euro
Objektiva specifike 2.2: Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orientimin në profile sipas kompetencave dhe interesave të fëmijës								
2.2.1	Përgatitja e materialeve informuese për prindër dhe nxënës.	Materialet e përgatitura	X	X	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	1200 €
2.2.2	Punëtori me prindër për promovimin e profileve arsimore dhe përparësitë e	3 punëtori ose takimeve të realizuara	X	X	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	300 euro

## Plani Komunal i Veprimi kundër Braktisë dhe Mosregjistrimit të Shkolës 2024-26

	orientimit të saktë të fëmijëve në shkollimin e mesëm Mesindhënesit e angazhuar nga SHML-te në takimet me prindër	3 takime ( në vit)							
2.2.3	Seminare për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta për të eksploruar aftësitë, interesat e tyre: Punëtori me kryetarët e klasave gjithsej 20 paralele	Nr. i seminareve e realizuara me nxënës	X	X	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	600 €	
2.2.3.	Takime të përbashkëta me prindër, nxënës me folës motivues.	Numri i takimeve të realizuara	X	X	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	300 €	
2.2.4	Hulumtim për numrin e nxënësve të regjistruar	Evidenca e nxënësve të regjistruar	X	X	X	Shkollat DA	Shkollat	0,0 euro	

## Plani Komunal i Veprimt kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkolles 2024-26

Objektiva specifike 2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të monitorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës.	nga klasa e 9-të në klasën e 10-të										Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
											2024	2025	2026			
2.3.1. Identifikimi i bizneseve dhe krijimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit																300 €
2.3.2. Zbatimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit sipas përgjegjësisive të ndara																0€

Të ftohen të gjitha bizneset vendore në një takim në shkollë të formuarë ekspozitës për promovimin të shkollës në mënyrë që të lidhen bashkëpunime mes shkollës dhe bizneseve

Nr. i shkollave dhe profileve përfituese të marrëveshjeve Nr. i nxënësve që mbështeten për punën praktike.

## Plani Komunal i Veprimt kundër Braktisë dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

	Nr. i nxënësve që mbështeten për punën praktike.				Shkolla për biznes	DKA Erit i punësimit	0.0
2.3.3	Hulumtimi sa nxënës janë të punësuar	Numri i nxënësve të	X	X	X		

## Objektiva specifike 2.4. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimt

Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
2.4.1. Zhvillimi dhe aprovimi i kornizës monitoruese.	Korniza monitoruese e zhvilluar	X				DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	0.0€
2.4.2. Mbledhja e të dhënave sipas kornizës monitoruese	Të dhënat e mbledhura	X	X	X		DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	0€
2.4.3. Analiza e të dhënave	Të dhënat e analizuara	X	X	X		DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	0€

Plani Komunal i Veprimi kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkolles 2024-26

2.4.4.	Raportimi mbi zbatimin e planit të veprimt	Raportimi i rregullt vjetor	X	x	X	DKA Shkollat	MASHIT Partneret	0€
--------	--	-----------------------------	---	---	---	--------------	------------------	----

Plani Komunal i Veprimt kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26

profil-arsimor-nie-tjeuin-prej-nje-shkolle-ne-shkollen-tjeur-nr-16-2011-date-30-12-2011/

- UA 08/2022 për dokumentacionin shkollor të arsimit parauniversitar, <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-masht-nr-08-per-dokumentacionin-shkollor-ne-arsimin-paramuniversitar/>
- UA 03/2012 Barasvlera dhe rrojthja e dokumenteve të arsimit parauniversitar të leshuara jashtë Republikës së Kosovës <https://masht.rks-gov.net/ua-barasvlera-dhe-rrojthja-e-dokumenteve-te-arsimit-paramuniversitar-te-leshuara-jashte-republike-se-kosoves-nr-03-2012-date-02-05-2012/>
- UA 19/2015, Për sistemin e nxënësve të çlëti kanë mriguar nga viti shkollor 2014/2015 <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-19-2015-per-sistemin-e-nxenesve-te-çlëti-kanë-mirguar-nga-viti-shkollor-2014+2015/>
- UA 1/2016, Përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe procedurave për organizimin e mësimi plotësues për nxënësit e riadhepsuar <https://masht.rks-gov.net/ua-nr-01-2016-di-12-01-2016-per-percaktimin-e-kushteve-kriterëve-dhe-procedurave-per-organizimin-e-mësimi-të-plotësues-per-nxenesit-e-riadhepsuar-organizimi-dhe-planifikimi-i-procesit-arsimor-ne-ars/>
- UA 01/2014 për organizimin dhe planifikimin e AAP <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-01-2014-organizimi-dhe-planifikimi-i-procesit-arsimor-ne-arsimin-dhe-afësimin-profesional/>
- UA 02/2014 Niveli i nxënësve në module dhe kualifikime të AAP, resurset, infrastrukturave dhe sigurisë e nxënësve <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-02-2014-niveli-i-nxenesve-ne-module-dhe-kualifikime-te-aap-resurset-infrastruktura-shkollore-siguria-e-nxenesve/>
- UA (MASHT) Nr. 06.2014 Kodi i mëtshjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta <https://ezk.rks-gov.net/AcdDocumentDetail.aspx?AcID=10128>
- UA-MASHT Nr. 12/2014 Përfshirjet në moshë në rësin e regjistrimit në arsimin dhe afësimin për të rritur <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-12-2014-perfshirjet-ne-moshë-ne-rësin-e-regjistrimit-ne-arsimin-dhe-afësimin-per-te-rritur/>

### Plani Komunal i Veprimt kundër Braktisë dhe Mosregjistrimit të Shkolles 2024-26

(Politika për mësimin dual ka filluar nga shtatori 2022 fillimisht në 4 profile: kuzhinier, asistent i restorantit, floktar dhe nurrator)

Ministria e Arsimit është e interesuar për sistemin dual të mësimt, me synimin që në secilën komunitë bashkëpunohet me bizneset që kanë mundësi punësimit për të rinjtë, duke u kujdesur për sigurinë në punë dhe çështjet që ndërlihen me punën që e bëjnë nxënësit nën moshën 18 vjet.

#### Strategjitë kombëtare/planet e veprimt

- Plani strategjik i arsimit në Kosovë (2022-2026),
- Strategjia për të drejtat e fëmijës (2019-2023),
- Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë (2022-2026),
- Strategjia dhe plani i veprimt për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare (2022-2026).

#### Të tjera

- *Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisë dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar* (MASHT, 2023)
- *Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisë dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar* (MASHT, 2023)
- Agjencia Gjermane për Bashkëpunimin Ndërkombëtar (GIZ). *Trajtimi i refuzimit të shkolles dhe braktisë: doracak i orientuar kah praktika [Dealing with school refusal and dropouts: A practice-oriented manual]* (tetor 2011).
- Raporti i OSBE-së: *Përcjellja e braktisë së shkolles dhe mosvijimit në Kosovë* <http://eeo.osce.org/sq/kosovo/95113?doenload=true> (qasur më 24 mars 2014).
- *Regjistrimi dhe braktisia e shkolles nga vajzat në Kosovë* (MASHT & UNICEF 2004).

Plani Komunal i Veprimt kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkolles 2024-26

- *Braktisja e shkolles nga nxënësi në Kosovë (MASHT, 2008)*
- *Instituti Pedagogjik i Kosovës, Fëmijët jashtë shkolles – Studiimi bazë për praktikën e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkolle (2014)*
- *UNICEF, Përmbledhje e Politikave - Të gjithë fëmijët regjistruohen, vijojnë dhe përfundojnë arsimimin, 2014*



Plani Komunal i Veprimi kunder Braktisjes dhe Mosegjistimit të Shkolles 2024-26


Duke u bazuar në këto të dhëna inkurajohet të gjithë qytetarët të shprehin interesin dhe të marrin pjesë në diskutimet dhe të marrin pjesë në vendimet për legalizimin e objekteve të ndërtuara para vitit 2018.

- Objektet të legalizuara 107
- Objektet në listën e pritjes 34
- Aplikimet me postë 47 (nga të cilat kemi 42 të pa kompletuara)

Nga fillimi i procesit të legalizimit të objekteve pa leje në Komunën e Shtimes përkatesisht në zyrën e Urbanizimit kemi 138 aplikime nga të cilat janë:

Ky raport bazohet në ligjin Ligji Nr. 06/L-024 për TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE të vitit 2018 dhe në ligjin për Ligji Nr. 08/L-184 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 05/L-024 PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE të vitit 2023

Data/Datum/Date:	22.02.2024
Nr./Br./No:	06/14
Per/Za/To:	Kuvendi Komunal-Shtime, Komiteti për Politikë dhe Financa
Nga/Od/From:	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadaster dhe Gjeodezi
Lenda/Predmet/Subject:	Raport për legalizimin e objekteve pa leje



Department of Urban Planning, Cadastre and Geodesy  
 Uprava za Urbanizam, Kadastar i Gjeodeziju  
 Drejtoria për Planifikim Urban, Kadaster dhe Gjeodezi

KOMUNA SHTIME-  
 OPŠTINA ŠTITIMJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

